

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XX, nr. 6029
E premte, 5 qershor 2020
çmimi 0.40 €

Kuvendi formon Komisionin Hetimor për menaxhimin e pandemisë Covid-19



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

FLET PËR "EPOKËN E RE", SHKËLZEN MALIQI

JETËGJATËSIA E QEVERISË HOTI VARET NGA SUKSESI I SAJ



Analisti politik Shkëlzen Maliqi ka bërë me dije se jetëgjatësia e qeverisë Hoti do të varet nga performanca e saj. Në këtë intervistë dhënë gazetës "Epoka e re", Maliqi ka thënë se nëse kjo qeveri është e

suksesshme mund ta çojë mandatin deri në fund. Ai ka vlerësuar se kryeministri Hoti e ka marrë përsipër që ta nxjerrë vendin nga ngërçi dhe bllokada që e konfrontonin shoqërinë. Sipas Maliqit, një

nga detyrat kryesore të kësaj qeverie është nënshkrimi i marrëveshjes historike me Serbinë. Ai i ka përmendur edhe sfidat e brendshme me të cilat do të përballlet qeveria Hoti



Kryeministri i ri i Kosovës, Avdullah Hoti, të enjten edhe zyrtarisht ka marrë detyrën, ani pse

HOTI MERR DETYRËN E KRYEMINISTRIT, KURTI NUK E PRET

atë nuk ia ka dorëzuar ish-kryeministri Albin Kurti ashtu siç është praktikuar deri më tani. Megjithatë, ai ka parakaluar para Gardës Ceremoniale të Forcës së Sigurisë

së Kosovës, e cila ishte rreshtuar në nderim të kryeministrit të ri. Pas marrjes së detyrës, kryeministri Hoti ka mbajtur mbledhjen e parë solemne, në të cilën e ka njoftuar kabinetin e vet me objektivat e qeverisë

AKTUALE

**ALBIN KURTI NËNSHKRUAN
PETICIONIN PËR ZGJEDHJE** F. 6

**BE-ja PRET QË HOTI TË
EMËROJË KRYENEGOCIATORIN
E KOSOVËS PËR DIALOG** F. 7

**AUTOSHKOLLAT KËRKOJNË
RIFILLIMIN E PUNËS** F. 6

EKONOMI



**PROTESTOJNË PUNËTORËT
E KEK-ut, KËRKOJNË
RIKTHIMIN E NJAZI THAÇIT** F. 9

**HAMZA: PAKOJA EMERGJENTE
ËSHTË DISKRIMINUESE PËR
BIZNESET DHE QYTETARËT** F. 8

**MIRATOHET KËRKESA
E TRUSTIT PËR TARIFËN
VJETORE MENAXHUESE** F. 8

SPORT



**FITORJA, E VETMJA
ALTERNATIVË PËR LLAPIN
KUNDËR DUKAGJINIT** F. 18

RENOVA
PUTZ
Macedoni
Xhepçisht-Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Rama për reformën zgjedhore: Hera e parë që BE-ja ndërhyt në politikën e brendshme të një shteti

TIRANË, 4 QERSHOR - Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, në fjalën e tij në parlament ka folur të enjten për zhvillimet e fundit politike sa i përket reformës zgjedhore. "Po e nis me reformën. Dua të sjell këtu se qysh pas zgjedhjeve të 2017-s jemi angazhuar që të adresojmë me synimin e vënies në jetë në zgjedhjet e 2019-s çështjen e elektronikës në zgjedhje. Prandaj kemi bërë një studim, kemi angazhuar një proces eksperimentimi të teknologjisë duke krijuar në selinë e PS-së qendra votimi për të parë reagimin dhe për të pasur një ide të qartë se si dhe sa mund ta përdorim. Dhe si përfundim kemi arritur në idenë që është e

mundur hakërimi, por sjell edhe lehtësira jo të vogla. Pavarësisht se ne mund t'i gjenim votat pa pritur asnjë lloj konsensusi nga ata që e braktisën parlamentin, ne nuk e bëmë dhe i shtymë afatet që i kemi vënë vetes në funksion të kësaj gjëje", ka thënë Rama.

Ai ka theksuar se Shqipëria dhe ndonjë vend tjetër janë raste unike pasi, sipas tij, as në Itali, as në Greqi apo Francë nuk bëhen me konsensus reformat elektorale. "Kush ka shumicën e bën. Ja në Greqi ndodhi kjo, kaloi nga sistemi proporcional në një të pastër pa bonus. Është e drejta e tyre patjetër, por në pamje të parë ndryshimi i një sistemi i heq atij vendi një



mundësi që i dha sistemi i konsoliduar prej shumë vitesh. Dhe në këtë proces janë dy tema:

e vendosur në tryezën nga BE-ja që për herë të parë ndërhyt në politikën e brendshme, falë

gjithë baltës dhe sherrit që u stimulua nga pala që mungon këtu sot", ka deklaruar Rama.

Arben Shehu i propozohet Kuvendit të Shqipërisë për t'u zgjedhur kryetar i Kontrollit të Lartë të Shtetit



PRISHTINË, 4 QERSHOR - Arben Shehu është emri i zgjedhur nga presidenti i Shqipërisë, Ilir Meta, që i propozohet Kuvendit të Shqipërisë për t'u zgjedhur kryetar i Kontrollit të Lartë të Shtetit. "Dr. Arben Shehu plotëson të gjitha kushtet dhe kriteret ligjore për t'u emëruar

në këtë pozicion si dhe është një kandidaturë me përvojë të gjatë në fushën e së drejtës dhe pedagogjisë. Gjatë përvojës mbi 16 vjeçare në jetën akademike, dr. Arben Shehu është një ndër njohësit më të mirë të drejtësisë penale. Z. Shehu është diplomuar edhe në fushën e

ekonomisë - Dega Administrim Biznesi, me një përvojë të gjatë akademike, kërkime dhe shkrime shkencore, por edhe përvojë të spikatur në zbatimin e ligjit si ushtrues aktiv i profesionit të avokatisë", thuhet në argumentimin e presidencës.

Edhe dy të vdekur nga Covid-19 në Maqedoninë e Veriut

SHKUP, 4 QERSHOR - Maqedonia e Veriut ka regjistruar shifra rekorde të personave të infektuar me koronavirus që nga fillimi i pandemisë. Ditën e enjte janë regjistruar 120 të infektuar me koronavirus, shifër kjo më e lartë sesa ajo e 15 prillit, kur ishte raportuar për 107 të infektuar. Sipas të dhënave të Institutit të Shëndetit Publik, në këtë shtet janë regjistruar edhe dy viktimat

nga qyteti i Tetovës, duke e çuar numrin e viktimave në 147. Prej tyre, 37 janë në Shkup, 25 në Tetovë, 24 në Kumanovë, 20 në Strugë, 10 në Veles, ndërsa në qytetet e tjera numri i viktimave është më i vogël se 10. Numri më i madh i të infektuarve mbetet në Shkup. Nga 120 rastet e reja, 66 janë në Shkup, që mbetet vatra kryesore e infektimit në Maqedoninë e

Veriut. Numër i lartë i të infektuarve është regjistruar edhe në Kumanovë, gjithsej 19 raste dhe në Prilep, 17. Rezultatet mbi të infektuarit dhe të vdekurit kanë dalë nga testimi i 953 mostrave. Shifra e lartë e testeve ka qenë edhe në ditët e kaluara, duke kaluar edhe shifrën e një mijë testeve brenda një dite. Që nga paraqitja e pandemisë janë realizuar mbi 33 mijë teste.



Zgjatet vlefshmëria e pasaportave në Shqipëri që skadojnë në 2020-n



Tiranë, 4 qershor - Vlefshmëria e pasaportave që skadojnë në 2020-n në Shqipëri është zgjatuar deri më 31 dhjetor të këtij viti. Vendimi është marrë nga Këshilli i Ministrave përmes

një akti normativ. Në bazë të VKM-së thuhet se afati i vlefshmërisë së pasaportave të shtetasve shqiptarë, që përfundon brenda vitit 2020, shtyhet deri më 31 dhjetor 2020. "Neni 2. Në ligjin nr.

8668, datë 23.10.2000, 'Për pajisjen e shtetasve shqiptarë me pasaportë për jashtë shtetit', të ndryshuar, pas nenit 14/2 shtohet neni 14/3, me këtë përmbajtje: 'Neni 14/3. Dispozitë

kalimtare/ Afati i vlefshmërisë së pasaportave të shtetasve shqiptarë, që përfundon brenda vitit 2020, zgjatet deri në datën 31 dhjetor 2020", thuhet në vendim.

Kryeministri i ri, Avdullah Hoti, ka mbajtur mbledhjen e parë të qeverisë

Hoti merr detyrën e kryeministrit, Kurti nuk e pret

Kryeministri i ri i Kosovës, Avdullah Hoti, të enjten edhe zyrtarisht e ka marrë detyrën, ani pse atë nuk ia ka dorëzuar ish-kryeministri Albin Kurti ashtu siç është praktikuar deri më tani. Megjithatë, ai ka parakaluar para Gardës Ceremoniale të Forcës së Sigurisë së Kosovës e cila ishte rreshtuar në nderim të kryeministrit të ri. Pas marrjes së detyrës, kryeministri Hoti ka mbajtur mbledhjen e parë solemne, në të cilën e ka njoftuar kabinetin me objektivat e qeverisë



pasur, detal, për rimëkëmbjen ekonomike, për t'u mundësuar bizneseve dhe familjeve e qytetarëve të vendit që sa më lehtë ta tejkalojmë këtë krizë të paprecedentë ndonjëherë në historinë e re të Kosovës dhe të mbarë botës", është shprehur ai, duke shtuar se kjo qeveri do të ndërtojë një diskurs tjetër nga ajo e kaluar. "Do të ndërtojim një diskurs tjetër, siç e thashë më herët, edhe brenda qeverisë, brenda këtij koalicioni qeverisës edhe në komunikim me opozitën, edhe në komunikim me shoqërinë civile, edhe në komunikim me mediat, duke ofruar transparencë të plotë me mënyrën se si qeveriset", është shprehur ai.

Kryeministri ka bërë me dije se do të ndërtojë kohezionin shoqëror që i ka munguar

Kosovës tash e një kohë për të punuar së bashku në interes të shtetit të Kosovës. "Prioritetet tona janë, përveç luftës kundër kësaj pandemie dhe rimëkëmbjes ekonomike, forcimi i shtetit ligjor, fuqizimi i miqësive tona me partnerët tanë ndërkombëtarë, marrja përsipër në baza kushtetuese të procesit të dialogut, adresimi i nevojave në arsim dhe në shëndetësi, në veçanti në arsim, duke pasur parasysh kushtet që janë krijuar tash për shkak të pandemisë, në veçanti të shëndetësisë për të krijuar kapacitete afatgjatë të sistemit tonë shëndetësor për ta përballuar situatën me pandeminë, por edhe në fusha të tjera. Përveç rimëkëmbjes ekonomike, një program shumë i pasur i zhvillimit ekonomik nëpër sektorë të ndryshëm", ka

thënë Hoti.

Gjatë ditës së enjte disa ministra të rinj kanë marrë detyrën. Ministrat e LDK-së atë e kanë bërë me ceremoni të dorëzimit, kurse ata të LV-së nuk e kanë bërë një gjë të tillë.

Bojkotimi i bashkërenditur i Osmanit dhe Kurtit nuk bëri punë

Kryetari i LDK-së, Isa Mustafa, ka thënë se bojkotimi i bashkërenditur i Vjosa Osmanit dhe Albin Kurtit nuk bëri punë. Në profilin e vet në "Facebook", ai ka shkruar se kryeparlamentarja Osmani dhe ish-kryeministri Kurti i kanë ikur përgjegjësisë në raport me formimin e qeverisë së re. "E para iku nga përgjegjësia ta drejtojnë seancën e Kuvendit, në të cilën bashkëpartiake i saj i LDK-së do të votohej për kryeministër, kurse partia e saj, LDK-ja, ku akoma është nënkryetare, do ta drejtonte koalicionin qeverisës. Veprim i paprecedan dhe i papërgjegjshëm. Sot Albin Kurti i iku përgjegjësisë t'ia dorëzojë detyrën kryeministrit Hoti. Deklarata e tij, se nuk ia dorëzon detyrën njeriut që e ka shkarkuar, është e ulët dhe e pasaktë. Në fakt, para se ta shkarkonte z. Hoti nga pozita e zëvendëskryeministrit të parë, Kurti e shkarkoi vetveten me votën e mbi 2/3 të deputetëve", ka shkruar Mustafa.

EPOKA E RE

Muhamet KOCI

PRISHTINË, 4 QERSHOR - Kryeministri i ri i Kosovës, Avdullah Hoti, të enjten ka nisur punën e tij në Qeverinë e Kosovës. Në një ceremoni shtetërore ai ka parakaluar para Gardës Ceremoniale të Forcës së Sigurisë së Kosovës, e cila ishte rreshtuar në nderim të kryeministrit të ri.

Hoti nuk është pritur nga ish-kryeministri Albin Kurti për t'ia dorëzuar detyrën e kryeministrit, siç është bërë tashmë traditë në Kosovë. Detyra i është dorëzuar nga sekretari i përgjithshëm i qeverisë, Fitim Krasniqi. Pas marrjes së detyrës, kryeministri Hoti ka mbledhur kabinetin qeveritar, ku ka prezantuar objektivat kryesore të qeverisë së re. Ai i ka uruar punë të mbarë kabinetit të tij, duke theksuar se objektivat kryesore të qeverisë së re do të jenë luftimi i pandemisë Covid-19, rimëkëmbja ekonomike, forcimi i shtetit ligjor, mirëmbajtja e partneritetit

me miqtë ndërkombëtarë, dialogu, arsimi dhe shëndetësia. "Do të punojmë bashkë për realizimin e një programi qeverisës mes të gjithë partnerëve të këtij koalicioni duke qenë llogaridhënës para të gjithë deputetëve të Kosovës, pozitë dhe opozitë, duke vendosur një diskurs të ri në skenën politike në vend. Është një program ambicioz për të cilin ne jemi pajtuar së bashku në javët e fundit. Unë besoj në atë program. Besoj në këtë ekip të shkëlqyeshëm nga partnerët e koalicionit që kanë ofruar ministra e zëvendëskryeministra me ekspertizë në fushën e tyre", ka thënë Hoti.

Ai ka thënë se kjo qeveri do t'u dalë zot pritjeve të qytetarëve. "Duhet t'i adresojmë menjëherë sfidat duke filluar nga pandemia, nga çështjet e rimëkëmbjes ekonomike, ku kemi një program siç e kam prezantuar dje në ekspozitë dhe do ta miratojmë së shpejti në program qeverisës kështu në qeveri, një program shumë voluminoz, të



Hoti bën homazhe te varri i Rugovës dhe te kompleksi 'Adem Jashari'

Kryeministri i Republikës së Kosovës, Avdullah Hoti, në ditën e tij të parë të punës në krye të qeverisë, bashkë me kabinetin qeveritar kanë bërë homazhe te varri i ish-presidentit historik të Kosovës, Ibrahim Rugova dhe në kompleksin memorial "Adem Jashari" në Prekaz. Ai e ka çmuar lart figurën e ish-presidentit Rugova, duke e quajtur atë themelues të shtetit. Gjatë kësaj vizite Hoti ka

premtuar se do të kujdeset për t'u siguruar që kullat e familjes Jashari të mbeten vend i shenjtë. "Ne sot, bashkë me kabinetin qeveritar, filluam ditën e parë të punës me nderimet që bëme në këtë vend të shenjtë. I pamë edhe pamjet e kullave dhe premtoj se do të ketë gjithë kujdesin e nevojshëm për të siguruar që ky vend i shenjtë të mbetet përgjithmonë vend ku kryhen nderimet dhe


ku bëhet pjesë e kujtesës sonë kombëtare për gjeneratat e ardhshme", ka thënë Hoti. Pas vizitës në Prekaz, Hoti ka qëndruar në Ministrinë e Shëndetësisë e cila udhëhiqet nga bashkëpartiake i tij, Armend Zemaj. Pasi ka falënderuar stafin mjekësor për punën e bërë gjatë pandemisë, Hoti ka thënë se qeveria e tij ka plan konkret për menaxhimin e koronavirusit.



FLET PËR “EPOKËN E RE”, SHKËLZEN MALIQI

JETËGJATËSIA E QEVERISË HOTI

Analisti politik Shkëlzen Maliqi ka bërë me dije se jetëgjatësia e qeverisë Hoti do të varet nga performanca e saj. Në këtë intervistë dhënë gazetës “Epoka e re”, Maliqi ka thënë se nëse kjo qeveri është e suksesshme mund ta çojë mandatin deri në fund. Ai ka vlerësuar se kryeministri Hoti e ka marrë përsipër që ta nxjerrë vendin nga ngërçi dhe bllokada që e konfrontonin shoqërinë. Sipas Maliqit, një nga detyrat kryesore të kësaj qeverie është nënshkrimi i marrëveshjes historike me Serbinë. Ai i ka përmendur edhe sfidat e brendshme me të cilat do të përballet qeveria Hoti

**EPOKA E RE** **Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 4 QERSHOR - Analisti politik Shkëlzen Maliqi ka deklaruar se jetëgjatësia e qeverisë së re është çështje e hapur. Ai ka deklaruar se kjo qeveri, nëse është e suksesshme, mund ta çojë mandatin deri në fund. Në këtë intervistë dhënë gazetës “Epoka e re”, Maliqi ka thënë se, nëse arrin t’i përmbushë disa detyra që i ka para vetes, qeveria e re mund ta kryejë një mision kyç për zgjedhjet e ardhshme. “Kjo mbetet çështje e hapur. Me rëndësi është performanca e qeverisë deri në fund të këtij viti. Nëse del e suksesshme, mund të marrë kreditë për ta vazhduar qeverisjen për sa është e nevojshme si qeveri transitore, ndoshta edhe për tre vjet të ardhshëm”, ka thënë Maliqi.

Ai ka vlerësuar se qeveria Hoti është zgjedhur me një shumicë minimale, por të mjaftueshme për legjitimitetin e saj. “Kryeministri Hoti e ka marrë përsipër që të nxjerrë vendin nga ngërçi dhe bllokada që e konfrontonin shoqërinë dhe nëse arrin që t’i përmbushë disa detyra imediate që i ka para vetes, p. sh., të nënshkruajë një marrëveshje të arsyeshme me Serbinë, të cilën e duan ShBA-ja dhe BE-ja, mund ta kryejë një mision kyç që në zgjedhjet e ardhshme, kurdo që të mbahen, të hyjmë pa atmosferën paranojake se ‘bota po na detyron ta pranojmë një marrëveshje të keqe’, pa e ditur se çfarë është ajo marrëveshje”, ka thënë Maliqi.

Analisti politik ka treguar edhe për pritjet nga qeveria e re në aspektin e brendshëm. “Prej qeverisë Hoti mund të pritjet që

të jetë më racionale dhe e kujdesshme për krijimin e një atmosfere të bashkëpunimit me sa më shumë faktorë vendorë dhe që t’i largohet konfliktualitetit. Ajo nuk do ta ketë luksin e injorimit të opozitës. Të paktën duhet ta mobilizojë shumicën e deputetëve shqiptarë në mënyrë që vendimet e mëdha për vendin të mos sprovohen nga mazhoranca minimale që e ka mbështetur në aktin e krijimit të saj”, është shprehur Maliqi.

“Epoka e re”: Z. Maliqi, për herë të parë, të mërkurën, Kuvendi i Kosovës ka votuar një qeveri e cila nuk e përfshin fituesin e zgjedhjeve. Në këtë mënyrë u krijua një standard që nuk është aplikuar deri më tani. Cili është vlerësimi juaj për formimin e kësaj qeverie?

Maliqi: Kuvendi i Kosovës ka qenë në të drejtën e tij që ta zgjedhë qeverinë e re pas dështimit të koalicionit LV-LDK. Qeveria Kurti nuk siguroi unitet të brendshëm, e ktheu kundër vetes 2/3 e Kuvendit me votimin e mocionit të mosbesimit, pastaj provoi që të qeverisë vetëm si LV

duke e krijuar një shumicë të përhershme me shkarkimin e zëvendëskryeministrit Hoti dhe ministrit Velu (ministrat e tjerë të LDK-së që mbetën në detyrë praktikisht nuk ishin pjesë e vendimmarrjeve), kështu që kjo anomali nuk ka mundur të zgjasë pa fund, është dashur që çështja e qeverisë të kthehet në Kuvend si institucion funksional dhe me mandat të plotë për vendimmarrje. Edhe pa vendimin e Gjykatës Kushtetuese ka qenë e qartë se fjala e fundit i takon Kuvendit, se vetëm Kuvendi mund ta shkarkojë veten për të shkuar në zgjedhje të reja, që ishte kërkesa e vetme e LV-së pasi që mendonte se zgjedhjet e përsëritura do t’i fitonte më bindshëm se ato të 6 tetorit. Albin Kurti kujtonte se mund ta detyrohet presidenti t’i shpallë zgjedhjet duke mos e konsideruar fare fuqinë e Kuvendit por, kjo nuk ndodhi. Gjykata Kushtetuese i dha të drejtë dekretit të presidentit. Është e vërtetë se qeveria Hoti u zgjodh me një shumicë minimale, por të mjaftueshme për legjitimitet. Kryeministri

Hoti e ka marrë përsipër që ta nxjerrë vendin nga ngërçi dhe bllokada që e konfrontonin shoqërinë dhe, nëse arrin që t’i përmbushë disa detyra imediate që i ka para vetes, p. sh., të nënshkruajë një marrëveshje të arsyeshme me Serbinë, të cilën e duan ShBA-ja dhe BE-ja, mund ta kryejë një mision kyç që në zgjedhjet e ardhshme, kurdo që të mbahen, të hyjmë pa atmosferën paranojake se “bota po na detyron ta pranojmë një marrëveshje të keqe”, pa e ditur se çfarë është ajo marrëveshje.

“Epoka e re”: Çfarë janë pritjet tuaja për qeverinë Hoti në aspektin e brendshëm?

Maliqi: Prej qeverisë Hoti mund të pritjet që të jetë më racionale dhe e kujdesshme në krijimin e një atmosfere të bashkëpunimit me sa më shumë faktorë vendorë dhe që t’i largohet konfliktualitetit. Ajo nuk do ta ketë luksin e injorimit të opozitës. Të paktën duhet ta mobilizojë shumicën e deputetëve shqiptarë në mënyrë që vendimet e mëdha për vendin të mos sprovohen nga mazhoranca minimale që e ka

mbështetur në aktin e krijimit të saj. Ajo duhet ta zbutë qëndrimin, nëse kjo është e mundshme, edhe ndaj LV-së, duke mos mbajtur mëri dhe revanshizëm ndaj saj, kurse nuk duhet assesi ta largojë nga konsultimet dhe vendimmarrjet PDK-në, e cila që nga 6 tetori ka thënë vazhdimisht se do të mbetet në opozitë, por premtonte se nuk do t’i pengojë vendimmarrjet për proceset më rëndësi jetike për Kosovën.

Një tjetër gjë që mund ta bëjë qeveria Hoti, edhe pse do ta ketë vështirë, është që të veprojë sa më mençur në tejkalimin e krizës ekonomike që e kërcënon vendin pas pandemisë. Ajo do të duhej të depolitizonte disa tema që në të kaluarën kanë krijuar paranoja dhe ndasi të ashpra politike. Këtu, para së gjithash, mendoj në masat ekonomike që do të mundësojnë rritjen e bashkëpunimit ekonomik rajonal dhe sidomos me Shqipërinë. Një tjetër gjë që mund të pritjet nga qeveria Hoti është vazhdimi i luftimit të korrupsionit dhe krimit të organizuar, për çka edhe ashtu do ta ketë opozitën dhe

VARET NGA SUKSESI I SAJ

mospajtimeve që kanë mes vete, BE-ja dhe ShBA-ja janë jetësisht të interesuara që Ballkanin Perëndimor ta largojnë nga sfera e influencës të Rusisë. Ajo që te ne perceptohet shpesh si favorizim i Serbisë karshi Kosovës, p. sh., kur BE-ja dhe ShBA-ja insistojnë që ta heqim taksën dhe reciprocitetin ndaj Serbisë, nuk është në funksion të dëmtimit të Kosovës si shtet sovran, por një veprim i përkohshëm që lehtëson vazhdimin e dialogut, që tani ka gjasa të shndërrohet në negociata finale politike për marrëveshje historike, që Kosovës duhet t'ia sigurojë anëtarësimin në OKB. Në këtë aspekt ne duhet të jemi racionalë dhe jo paranojakë dhe refuzues ndaj kompromiseve (do t'i quaja të buta) për të cilat do të duhej të vendosim, nëse alternativa për këto kompromise do të ishte mbetja në një pozitë siç jemi sot, pa njohje universale ndërkombëtare. Ky do të jetë sovranitet i Kosovës dhe jo kjo që kemi sot.

“Epoka e re”: Liderët e partive politike që e përbëjnë koalicionin qeverisës, Mustafa Haradinaj dhe Limaj, nuk do të jenë pjesë e qeverisë. Sa mund të ndikojë kjo në funksionimin e këtij kabineti qeveritar?

Maliqi: Mendoj se ky është një zhvillim pozitiv sepse gradualisht pushteti dhe përgjegjësia po kalon te brezi më i ri i politikanëve. Ky lloj i rreshtimit të pushtetit në dy eshallone, ku të vjetrit dhe të fuqishmit i kontrollojnë partitë, por të rinjtë janë në funksione ekzekutive, më duket si model i vin-vin situatës, ku të fuqishmit të djeshëm nuk ndihen të marginalizuar dhe pa ndikim, e as udhëheqësit ekzekutivë që drejtojnë dikasterët nuk do të duhej të vepronin në varësi nga bosët e tyre partiak, nëse duan që të kenë karrierë të suksesshme, sepse duhet të tregojnë iniciativë, të mendojnë me kokën e vet dhe jo të janë marioneta.

“Epoka e re”: Opozita e kësaj qeverie e cila u formua me minimumin e votave do të jetë mjaft e fuqishme. Sa pritni të jetë jetëgjatësia e kësaj qeverie?

Maliqi: Kjo mbetet çështje e hapur. Me rëndësi është performanca e qeverisë deri në fund të këtij viti. Nëse del e suksesshme, mund t'i marrë kreditë për ta vazhduar qeverisjen për sa është e nevojshme si qeveri transitore, ndoshta edhe për tre vjetët e ardhshëm.

Kuvendi formon Komisionin Hetimor për menaxhimin e pandemisë Covid-19

PRISHTINË, 4 QERSHOR - Me 75 vota për, 10 abstenime dhe asnjë votë kundër, deputetët e Kuvendit të Kosovës kanë formuar Komisionin Hetimor Parlamentar në lidhje me menaxhimin e pandemisë Covid-19 nga ana e Qeverisë së Republikës së Kosovës, e cila drejtohej nga ish-kryeministri Albin Kurti. Në fillim të seancës, kryetarja e Kuvendit, Vjosa Osmani, ka bërë me dije se deputetja e Zikrete Aliti në përputhje me procedurat administrative të Kuvendit ka dhënë dorëheqje nga grupi parlamentar 6+ dhe, si i tillë, ky grup parlamentar është shpërbërë, pasi numri i anëtarëve të grupit ka rënë nën minimum. Para se të vihet në diskutim formimi i Komisionit Hetimor, deputetët kanë ngritur çështje për tema të cilat nuk ishin të përfshira në rendin e ditës mirëpo, sipas tyre, kanë qenë relevante dhe mjaft të rëndësishme për qytetarët e Kosovës. Ndërsa sa i përket nismës për formimin e Komisionit Hetimor në lidhje me menaxhimin e pandemisë Covid-19 nga ana e Qeverisë së Kosovës, arsyetimin e ka paraqitur deputetja e PDK-së, Eliza Hoxha, në cilësinë e propozuesit të këtij komisioni. “Ne si parashtrues të kësaj kërkesë theksojmë

nevojën e madhe të këtij hetimi, pasi që nga ana e qeverisë që ka qenë në detyrë janë marrë veprime ad hoc dhe në të njëjtën kohë janë shkelur edhe të drejtat dhe liritë e njeriut. Theks i veçantë i kushtohet rastit tragjik që ka ndodhur në qendrën e karantinimit. Andaj, nga ky komision, i cili do të përbëhet nga 11 anëtarë, prej të cilëve tre nga LV-ja, tre nga LDK-ja, dy nga PDK-ja, si dhe nga një anëtar nga AAK-ja, Nisma-AKR si dhe Lista Serbe, pritet të hetohen të gjithat parregullsitë për të cilat janë ngritur dyshime nga ana e deputetëve”, ka thënë deputetja Hoxha. Ndërsa kryetari i grupit parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje, Rexhep Selimi, ka thënë se, përkundër faktit se ky propozim ka pësuar mutacion me kalimin e kohës, grupi i tij parlamentar mbështet me vendosmëri dhe ofron bashkëpunim ndaj këtij propozimi. Ndërsa deputeti Ilir Ferati në emër të grupit parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), zbardhjen e të gjitha dyshimeve në lidhje me menaxhimin e pandemisë Covid-19 e ka vlerësuar si të domosdoshëm krijimin e këtij komisioni. Më tutje, deputeti i PDK-së,

Uran Ismaili, ka thënë se për shkak të parregullsive që janë vërejtur gjatë kësaj kohe janë shtuar edhe objektivat e këtij komisioni. Kurse Time Kadrijaj nga grupi parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) e ka konsideruar shumë të nevojshme krijimin e këtij komisioni. Formimi i komisionit në fjalë është mbështetur nga grupi parlamentar i Nismës dhe ai i Listës Serbe. Formimin e Komisionit Hetimor e ka mbështetur edhe kryetarja e Kuvendit, Vjosa Osmani. Kryesuese e këtij komisioni do të jetë deputetja Mimoza Kusari-Lila, zëvendëskryesuese deputetja Eliza Hoxha, ndërsa anëtarë do të jenë: Labinotë Demi-Murtezi, Fatmire Mulhaxha-Kollçaku, Ekrem Hyseni, Ilir Ferati, Veton Berisha, Bekim Haxhiu, Shkumbin Demaliaj, Endrit Shala dhe Millosh Petroviq. Pas formimit të komisionit, seanca ka vazhduar punimet me dy pikat e tjera. Deputetët kanë miratuar kërkesën e Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për miratimin e taksave vjetore për vitin 2020 si dhe propozimet e grupit parlamentar të LV-së dhe atij të PDK-së për zëvendësimin e deputetëve në komisionet parlamentare.



kontrollin e fortë nga LV-ja dhe PDK-ja. Në esencë, kjo është bërë tani edhe një çështje që e kërkon shumica e shoqërisë. Por, mendoj se kjo nuk mund të bëhet vetëm me fushata propagandistike të ndryshimit të “bordeve të kapura” me vendime arbitrare. Kosovës i duhet, si Shqipërisë, një proces i strukturuar i vetingut i ndihmuar nga BE-ja dhe ShBA-ja. Për këtë duhet pasur para sysh edhe përvojën e Shqipërisë, me pengesat e shumta për vetingun që e kanë vonuar atë nga ndikimi i monopolistëve politikë dhe ekonomikë.

“Epoka e re”: Në aspektin e jashtëm, ShBA-ja dhe BE-ja në urimet e tyre e kanë bërë të qartë që mezi presim të bashkëpunojnë me qeverinë e re për vazhdimin e dialogut me Serbinë. Besoni se kjo qeveri do ta mund ta përmbyllë këtë proces?

Maliqi: Politikanët, por edhe opinioni në Kosovë, nuk janë të vetëdijshëm se ne jemi në epiqendër të një procesi ku, përkundër kontradiktave dhe

IKD: Gjykatat dështuan në masë të madhe t'i zbatojnë obligimet sipas Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit në Kosovë



**EPOKA
ERE** **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 4 QERSHOR - Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD), me përkrahje të Departamentit të Shtetit Amerikan - Byrosë së Narkotikëve Ndërkombëtar dhe Çështjeve të Zbatimit të Ligjit (INL) dhe NED-it, të enjten ka mbajtur konferencë për media, në të cilën ka publikuar raportin "Dështimi i gjykatave në mbushjen e Programit për Kompensimin e Viktimave të Krimit" si rezultat i monitorimit dhe hulumtimit sistematik.

Arrita Reznici, hulumtuese në IKD, tha se Ligji për Kompensimin e Viktimave të Krimit ka hyrë në fuqi në vitin 2015 dhe si rrjedhojë ka shënuar një hap përpara në aspektin e përmirësimit të pozitës së viktimave të krimit në vend. Sipas saj, përkundër se

jemi në vitin e gjashtë prej kur ka hyrë në fuqi ky ligj, praktika po dëshmon se zbatimi i tij lë për të dëshiruar.

Hulumtuesja Reznici ka deklaruar se që nga funksionalizimi i punës së Komisionit për Kompensimin e Viktimave të Krimit janë pranuar gjithsej 50 kërkesa për kompensim, nga të cilat 20 janë refuzuar, 15 janë aprovuar dhe 15 janë ende duke u trajtuar.

"Nga ato të aprovuarat, vlera më e lartë e kompensimit ka arritur shumën prej 6 000 eurosh, kurse 2 000 euro ka qenë vlera më e ulët e kompensimit që ky komision e ka aprovuar", ka thënë ajo.

Ndërsa sa i përket Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit, hulumtuesja Reznici ka pohuar se i njëjti shprehimisht ka paraparë obligimin e gjyqtarëve që me rastin e shqiptimit të sanksioneve

penale, t'i obligojë të akuzuarit t'i paguajnë edhe taksat për kompensimin e viktimave. "Këto taksa ndahen në dy grupe, për veprat penale që gjykohen nga Departamenti i Përgjithshëm i Gjykatës Themelore kërkohet pagesa e shumës prej 30 eurosh, kurse për veprat penale që gjykohen nga Departamenti i Krimeve të Rënda i Gjykatës Themelore kërkohet shuma prej pesëdhjetë 50 eurosh", ka bërë me dije ajo.

Reznici ka theksuar se duke u bazuar në intervistat e zhvilluara, IKD ka gjetur se sfidë shumë e madhe për gjyqtarët, sidomos në vitet e para pas hyrjes në fuqi të këtij ligji e deri në pranimin e Qarkores nga Gjykata Supreme ka qenë fakti se neni 39 i LKVK-së nuk është kuptuar drejt dhe në mënyrë të plotë nga gjyqtarët. "Në anën tjetër, për

ata që, megjithatë, e kanë pasur krejtësisht të qartë këtë dispozitë, nga analiza e aktgjykimeve del se sfidë e kanë pasur zbatimin e së njëjtës. Në këtë drejtim, IKD nuk ka gjetur asnjë aktgjykim të vitit 2015 i cili ka obliguar të pandehurit e dënuar që të paguajnë një taksë 50 apo 30 euro (varësisht nga departamenti ku është gjykuar). Ndërsa, përpos aktgjykimeve të analizuara, ky konstatim është vërtetuar edhe nga përgjigjet e dhëna nga udhëheqësit e gati të gjitha gjykatave e, po ashtu, edhe nga të dhënat të cilat IKD i ka pranuar nga KGJK-ja mbi të hyrat e gjykatave nga këto taksa", tha Reznici.

Krahas kësaj, hulumtuesja e IKD-së tregoi se, po ashtu, kanë evidentuar aktgjykime të gjykatësve të njëjtë, të cilët në disa raste e kanë zbatuar LKVK-në dhe kanë obliguar të

pandehurit e dënuar që të paguajnë taksën 30 apo 50 euro (varësisht nga departamenti ku po gjykohej vepra penale), por se të njëjtit gjyqtarë në disa raste të tjera nuk kanë vepruar në mënyrë të njëjtë.

Leotrim Gashi, hulumtues në IKD, theksoi se një element tjetër shumë i rëndësishëm i evidentuar si rrjedhojë e procesit sistematik të monitorimit të të gjitha seancave gjyqësore në vend, në të gjitha instancat gjyqësore, është fakti se në shumicën dërrmuese të rasteve kemi mosnjohim të duhur të viktimave lidhur me të drejtat e tyre çka, sipas tij, bën që kjo kategori e ndjeshme të mos arrijë realizimin e plotë të drejtave të veta, meqë tha se nuk kanë mjaftueshëm njohuri mbi të drejtën e tyre për kompensim dhe as për pasojat e heqjes dorë nga kompensimi.

Autoshkollat kërkojnë rifillimin e punës



PRISHTINË, 4 MARS - Dhjetëra instruktorë e pronarë të autoshkollave kanë protestuar sot para objektit të Ministrisë së Infrastrukturës. Janë rreth 300 autoshkolla në Kosovë të cilat ka tash e më shumë se dy muaj që nuk kanë ushtruar veprimtarinë për shkak të pandemisë Covid-19. Ata kanë thënë se janë duke u neglizhuar nga Ministria e Infrastrukturës, ndonëse as në fazën e tretë të lehtësimit të masave nuk është duke iu lejuar të punojnë dhe për këtë kanë thënë se kanë pasur humbje të madhe. Kryetari i Federatës së

Autoshkollave të Kosovës, Xhemshir Cakolli, ka thënë se janë neglizhuar nga Ministria e Infrastrukturës në përfshirjen e kësaj veprimtarie në fazën e tretë të lehtësimit të masave kundër Covid-19. Për këtë, ai ka thënë se kanë dërguar disa shkresa në ministri, por që nuk u është përgjigjur.

Cakolli ka thënë se është një numër i madh i kandidatëve të cilët kanë aplikuar më 8 mars për patentshofer, por që ende nuk kanë filluar as mbajtjen e orëve teorike. Ndër të tjera, ai ka thënë se janë duke paguar poligon.

Albin Kurti nënshkruan petitionin për zgjedhje

PRISHTINË, 4 QERSHOR (ER) - Ish-kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka nënshkruar të enjten petitionin për zgjedhje të reja të

iniciuar nga partia që drejton, Lëvizja Vetëvendosje. Kurti ka theksuar se zgjedhjet janë qëllimi i tyre politik, duke i ftuar qytetarët

ta nënshkruajnë këtë petition. "Zgjedhjet janë qëllimi ynë politik sepse zgjedhjet janë parimi i shkelur demokratik. I ftoj të gjithë

qytetarët që ta nënshkruajnë petitionin në sheshin e qytetit të tyre nëse nuk e kanë bërë këtë deri më tani", ka deklaruar Kurti.



BE-ja pret që Hoti ta emërojë kryenegociatorin e Kosovës për dialog

Bashkimi Evropian (BE) është duke pritur që Qeveria e Kosovës, e kryesuar nga Avdullah Hoti, të emërojë një kryenegociator për dialog dhe një ekip të Kosovës për këtë proces

PRISHTINË, 4 QERSHOR - Bashkimi Evropian (BE) dëshiron që sa më parë të rifillojë dialogu në mes të Kosovës dhe Serbisë dhe që qëllimi i këtij rifillimi të jetë edhe përfundimi sa më i shpejtë i këtij dialogu përmes një marrëveshje gjithëpërfshirëse.

Këtë e ka thënë të enjten një zyrtar i lartë i BE-së duke thënë se BE-ja, po ashtu, pret që Qeveria e Kosovës, e kryesuar nga Avdullah Hoti, të emërojë një kryenegociator për dialog dhe një ekip të Kosovës për këtë.

Në BE pohojnë se u takon qytetarëve të Kosovës të vendosin se kush do t'i përfaqësojë dhe, po ashtu, edhe BE-ja vendos se kush do ta përfaqësojë atë. Kjo u tha duke pasur parasysh pohimet e presidentit të Kosovës, Hashim Thaçi, se ai nuk do të marrë pjesë në dialogun që e ndërmjetëson i dërguari i posaçëm i BE-së Miroslav Lajçak.

Ky i fundit thuhet të ketë biseduar me shumë zyrtarë të Kosovës, por jo edhe me presidentin Thaçi i cili ka dërguar porosi se "nuk ka kohë sepse është i zënë duke u përballur me pandeminë".

Në BE konsiderojnë se tash ka një person, duke aluduar në të dërguarin e posaçëm i cili do të

merret me dialog 24 orë në ditë dhe kjo dëshmon se BE-ja e ka kuptuar se kësaj teme, si dhe tërë rajonit, duhet kushtuar më shumë kujdes. Po ashtu, në qasjen e re të dialogut BE-ja dëshiron të jetë më konkrete e jo duke pasur një qasje të dykuptimësisë së qëllimshme

siç ka pasur më herët. Ndryshimi i kufijve, thonë tashmë shumë burime në BE, nuk do të jetë në tryezë sepse është kuptuar se një ide e tillë ka ndikim negativ, është kundër vlerave evropiane dhe zakonisht pasohet me lëvizje edhe të njerëzve në baza etnike.

Pikërisht për shkak të ndikimit që mund të ketë në rajon, si dhe në të ardhmen evropiane të rajonit, BE-ja nuk do t'ua lë Beogradit dhe Prishtinës krejtësisht në dorë se çfarë mund të jetë marrëveshja.

Prandaj insistojnë që marrëveshja e cila do të duhej të arrihej mes palëve të jetë e pranueshme edhe për BE-në, të jetë në përputhje me të drejtën ndërkombëtare dhe të ketë ndikim pozitiv dhe stabilizues në rajon. Një marrëveshje e cila do të nënkuptonte ndryshimin e kufijve nuk besohet se do të ishte e tillë.

Burimet e BE-së pohojnë se i dërguari i posaçëm Miroslav Lajçak planifikon që sa më parë ta vizitojë Prishtinën dhe Beogradin për të pasur kontakte personale me

partnerët në mënyrë që të rifillojë dialogu. Ky dialog pritet të zhvillohet në Bruksel.

BE-ja e mirëpret rolin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në dialog. Në BE pohojnë se ShBA-ja ka pasur rol në dialog edhe në të kaluarën si dhe një rol të pazëvendësueshëm edhe në rajon, krahas BE-së. Por, në BE presin që të ketë më shumë transparencë edhe nga ajo çfarë po bën administrata amerikane me ndihmën palëve që ta arrijnë normalizimin e raporteve. (Rel)



Ecuria e dialogut Kosovë - Serbi është tërësisht e paqartë

PRISHTINË, 4 QERSHOR - Presidenti i Akademisë Diplomatike Shqiptare, Lisen Bashkurti, ka thënë se ecuria e dialogut Kosovë - Serbi është tërësisht e paqartë. Në një intervistë për 'Konfident' ka thënë se kriza politike do ta tensionojë dhe polarizojë akoma më shumë klimën politike dhe institucionale në Kosovë. "Polemika për hapjen e negociatave dhe përbajtjen e tyre do të thellohet akoma më tej. Mundësia për mbështetje politike të gjerë të procesit dhe përbajtjes së negociatave duket se nuk do të ndodhë edhe për disa kohë. Klima e acaruar politike, polarizimi i skajshëm dhe mungesa e bazës së gjerë politike në mbështetje të



negociatave dhe përbajtjes së tyre janë pengesa serioze të brendshme në Kosovë". "Në rrafshin ndërkombëtar ka, gjithashtu, disa situata politike e diplomatike aspak të qarta, madje mund të thuhet të

turbullta. Hapjen e negociatave e mbështesin të gjithë, në të gjithë hapësirat gjeopolitike dhe në të gjitha nivelet. Debatet, polemikat dhe mospërputhjet lidhen me projektin e lansuar për shkëmbimet territoriale, çka

nënkupton copëtimin e Kosovës. Në BE dhe në Evropë ka dy alternativa në qasje me përbajtjen e negociatave Serbi - Kosovë. Politika e jashtme dhe diplomacia e BE-së, sikundër qasja individuale e Gjermanisë, Francës, Britanisë së Madhe, shteteve të rajonit është kundër opsionit të 'shkëmbimit territorial', opsion ky i iniciuar nga Serbia, i nxitur nga Rusia dhe i mbështetur nga liderët lokalë, Thaçi dhe Rama. Në Shtëpinë e Bardhë, gjithashtu, paqartësitë janë të dukshme. Ka deklarime e qëndrime kontroverze, që kanë nisur në mënyrë të veçantë mbas emërimit të Richard Grenellit si i ngarkuar special për dialogun Serbi - Kosovë nga presidenti

Trump", ka thënë Bashkurti. Ai ka theksuar se shqetësimi më serioz vjen nga mospërputhjet midis BE-së e Fuqive Evropiane dhe Shtëpisë së Bardhë lidhur me përbajtjen përfundimtare të marrëveshjes Serbi - Kosovë për normalizimin e marrëdhënieve. "Ka një diskordancë midis Evropës dhe ShBA-së, në mënyrën se si po elaborohen idetë e përbajtjes së marrëveshjes së pritshme si dhe shpejtësisë së arritjes së saj", ka deklaruar Bashkurti. Ai ka shtuar se duke pasur parasysh se Kosova është projekt Euro-Atlantik, atëherë është e domosdoshme që midis Evropës dhe ShBA-së të ketë mirëkuptim të plotë për këtë projekt deri në përfundimin e tij.

Hamza: Pakoja emergjente është diskriminuese për bizneset dhe qytetarët

PRISHTINË, 4 QERSHOR - Shefi i grupit parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Bedri Hamza, në seancën e Kuvendit të Kosovës ka folur të enjten për gjendjen ekonomike në Kosovë si pasojë e pandemisë Covid-19. Me këtë rast, Hamza ka thënë se gjendja në të cilën gjendet Kosova rrezikon jo vetëm shëndetin, por edhe ekonominë e vendit.

Ai ka theksuar se Pakoja Emergjente ka qenë diskriminuese për bizneset dhe qytetarët. "Pandemia ka ndikuar edhe në ekonomi. Nëse kjo vazhdon, do të ketë dëme të mëdha. Shtetet në botë kanë intervenuar deri në 10 për qind të Bruto Produktit Vendor. Qeveria e kaluar e ka miratuar një buxhet, por nuk ka përfshirë një gjë të tillë. Në buxhetin e miratuar

deputetët janë privuar nga dhënia e mendimeve dhe ndihma të buxheti", ka thënë Hamza, duke shtuar se bizneset ende nuk i kanë pranuar mjetet financiare të cilat ishin paraparë me pakon emergjente të qeverisë Kurti. "Partia Demokratike e Kosovës (PDK) ka qenë e hapur për të dhënë këshilla, për të pranuar kritika dhe për të bashkëpunuar. Deri më

tani janë paguar 55 milionë apo rreth 1 për qind e bruto produktit vendor. Tani dilema shtrohet se si duhet të paguhet ato. Është ndarë nga një pagë prej 170 eurosh për punëtorët, por nuk i kanë marrë të gjithë edhe këtu janë bërë selektive. Bizneset akoma s'i kanë pranuar mjetet financiare për shpenzimet operacionale", ka thënë Hamza.



OEAK-u: Ndërmjetësimi, mundësi e zgjidhjes së kontesteve biznesore në kohë pandemie

EPOKA E RE

A. MAVRAJ

PRISHTINË, 4 QERSHOR - Pandemia Covid-19, përveç ndikimit që ka pasur mbi shëndetin publik dhe veprimtarinë ekonomike, ka goditur rëndë edhe veprimtarinë gjyqësore, rrjedhimisht duke shkaktuar grumbullimin e çështjeve dhe kontesteve të cilat nuk mund të zgjidhen pa praninë e palëve në gjykatë. Përdorimi i ndërmjetësimi si metodë efektive e zgjidhjes së kontesteve për ta lehtësuar veprimtarinë e gjykatave, sidomos gjatë kësaj kohe, ishte tema e diskutimit në forumin virtual të radhës, organizuar nga Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë.

Makifete Saliuka, zëvendëskryesuese e Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK), ka theksuar se si rezultat i pandemisë është punuar me kapacitete të reduktuara dhe gjykatat kanë trajtuar vetëm çështjet më urgjente. Megjithatë, sipas saj, Komisioni

për Administrimin e Gjykatave në planin për menaxhim të krizave ka paraparë edhe mundësinë për mbajtjen e seancave gjyqësore online, ku edhe janë realizuar disa seanca të ndërmjetësimi të siguruara nga programi i USAID-it për Drejtësi Komerciale.

Sa i përket ndërmjetësimi, Saliuka ka theksuar se zhvillimi shoqëror dhe ekonomik, sado i mirëpritur, shpeshherë ka sjellë edhe mosmarrëveshje mes palëve, gjë që ka ndikuar në nevojën për një metodë alternative për zgjidhjen e kontesteve. Ajo ka shtuar se ndërmjetësimi si proces duhet të respektohet dhe përdoret nga palët dhe gjykatat si dispozitë imperative për zgjidhjen e çështjeve familjare apo ekonomike dhe se janë vënë themele të qëndrueshme të ndërmjetësimi në Kosovë me anë të të cilit nuk do të shkelet e drejta bazë e çdo njeriu për një gjykim të drejtë.

Ndërsa Faton Morina, kryetar i Odës së Ndërmjetësuesve, ka



thënë se ndërmjetësimi në shoqërinë tonë ka filluar në vitin 2008, ndërsa funksionalizimi i plotë i tij si proces është bërë në vitin 2012, pas licencimit të ndërmjetësuesve të parë nga Ministria e Drejtësisë. Morina ka theksuar se si rrjedhojë e ndalimit të përkohshëm të veprimtarive nga pandemia Covid-19, institucioni që ai drejton nuk ka pasur punë

të ngarkuar, por me anë të metodave alternative ka vazhduar veprimtarinë, ku është përfshirë edhe mbajtja e seancave të ndërmjetësimi online e mbështetur nga USAID. Morina ka shtuar se seancat e mbajtura online nuk kanë qenë shumë të ndryshme nga rastet e trajtuara në gjykatë dhe se avantazhi i ndërmjetësimi qëndron në faktin se palët mund

ta përdorin si metodë më të lehtë për zgjidhjen e kontesteve, njëkohësisht si proces më të shpejtë. Ai ka potencuar se deri më tani nuk ka ndonjë rast të kontesteve të trajtuara përmes ndërmjetësimi që është kthyer për ritrajtim, ndërsa ka theksuar se shpreson që kjo metodë të fillojë të përdoret më shumë nga palët për çfarëdo lloj rasti apo kontesti.

Mbi 52 mijë vizitorë qëndruan në hotele në tremujorin e parë të këtij viti

Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) ka publikuar "Statistikat e Hotelierisë në Kosovë" për tremujorin e parë (TM1) të vitit 2020. Në tremujorin e parë të vitit 2020 pjesë e anketës kanë qenë 215 hotele që ushtrjnë veprimtari hoteliere në territorin e Kosovës. Pjesa më e madhe e hoteleve

gjenden në rajonin e Prishtinës dhe Pejës. ASK-ja ka bërë me dije se gjatë kësaj periudhe kohore hotelet e Kosovës janë vizituar nga 52 829 vizitorë. "TM1 2020, numri i vizitorëve (vëndorë dhe të huaj) ishte 52 829, prej tyre 41.38 për qind ishin vëndorë dhe 58.62 për qind ishin të jashtëm. Ndërsa numri i net-qëndrimeve

ishte 85 929, prej tyre 40.87 për qind nga vëndorët dhe 59.13 për qind nga të huajt", ka njoftuar ASK-ja.

Kjo agjenci ka theksuar se numrin më të madh të vizitorëve dhe net-qëndrimeve të tyre e ka pasur rajoni i Prishtinës me 20 486 vizitorë dhe 34 105 net-qëndrime. "Numri më i madh i



vizitorëve të huaj përqendrohet në Prishtinë, Prizren, Pejë e kështu me radhë. Sa iu përket

vizitorëve të huaj, numri më i madh është nga Shqipëria, Turqi, Gjermania etj. Këtij publikimi i është bashkangjitur edhe një shtojcë e veçantë, që përmban të dhëna nga Policia e Kosovës lidhur me numrin i vizitorëve të huaj sipas pikëkalimeve kufitare gjatë vitit 2017-2019", ka njoftuar ASK-ja.

Miratohet kërkesa e Trustit për tarifën vjetore menaxhuese

Prishtinë, 4 mars (ER) - Deputetët e Kuvendit të Kosovës me 73 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim kanë miratuar kërkesën e Fondit të Kursimeve Pensionale (Trust) për taksën vjetore për vitin 2020. Në fillim të muajit mars Komisioni për Buxhet dhe Transfere i Kuvendit kishte miratuar



kërkesën e Trustit për miratimin e buxhetit dhe tarifës menaxhuese. "Kuvendi mira-

toi kërkesën e Fondit të Kursimeve Pensionale për caktimin e taksës investive prej 0.33 përqindësh dhe taksës operacionale prej 0.065 përqindësh për vitin 2020", ka thënë kryetarja e Kuvendit, Vjosa Osmani.

Ndërsa kryetari i këtij Komisioni për Buxhet dhe Transfere, Hekuran Murati, më

herët kishte treguar se Trusti ka kërkuar që të investohet në fondet që kanë tarifë menaxhuese më të lirë. "Ka qenë kërkesë e komisionit dhe që është mbështetur me shumicë të votave nga anëtarët, që Fondi i Kursimeve Pensionale apo i ashtuquajtur Trusti ta ripërpunojë buxhetin, planin e shpenzimeve vjetore dhe ta

dorëzohet me disa masa të kursimeve, e ndër këto kanë qenë disa shpenzime apo përfitime te personeli dhe, po ashtu, edhe te tarifa menaxhuese për investimet, pra të investohet në fondet që kanë tarifë menaxhuese më të lirë, duke mos rrezikuar performancën apo kthimin e fondeve", pati thënë Murati.

Protestojnë punëtorët e KEK-ut, kërkojnë rikthimin e Njazi Thaçit

Punëtorët e Korporatës Energjetike të Kosovës (KEK) kanë protestuar të enjten. Ata kanë kërkuar nga bordi i përkohshëm i kësaj korporate që ta rikthejë në punë Njazi Thaçin, të cilin e kishte shkarkuar nga pozita e drejtorit ekzekutiv. Protestuesit e kanë quajtur Njazi Thaçin kryehero për, siç kanë thënë ata, performancën që ka treguar sa ka qenë në krye të KEK-ut. Pas kësaj proteste, organizatorët e saj janë shoqëruar në polici



pas emërimit nga Qeveria Kurti kishte shkarkuar Njazi Thaçin nga pozita e drejtorit ekzekutiv në këtë korporatë. Këtë vendim e kishte kundërshtuar Thaçi, duke iu drejtuar Inspektoratit të Punës, i cili më 27 maj ka kërkuar nga bordi i përkohshëm i KEK-ut që ta rikthejë në punë drejtorin e shkarkuar.

Pesë punëtorë të KEK-ut dalin pozitivë me Covid-19

Pesë punëtorë të KEK-ut kanë dalë pozitivë me Covid-19. KEK-u ka njoftuar se do të gjurmohen të gjitha kontaktet të cilat më pas do të testohen. "Ju njoftojmë se pas testeve të

bëra për Covid-19 kanë rezultuar pozitivë edhe pesë kolegë tanë. Prandaj, kemi bërë planin që të gjurmohen kontaktet në KEK të cilët do të dërgohen menjëherë për testim. Të gjithë punëtorët që kanë pasur kontakte me personat e infektuar duhet që paraprakisht të vetizohen duke shmangur kontaktet me familjarët dhe kolegët", ka njoftuar KEK-u.

Kjo korporatë ka kërkuar nga të gjithë punëtorët që të vazhdojnë të kujdesen për higjienën, ta ruajnë distancën sociale dhe t'i respektojnë rekomandimet e institucioneve shëndetësore. "Në ndërkohë kërkojmë nga të gjithë punëtorët që të vazhdojnë ta

mbajnë higjienën dhe distancën sociale. Me rëndësi të veçantë të gjitha grumbullimet janë të ndaluara për shkaqe të evitimit të pandemisë. Menaxherët dhe mbikëqyrësit kanë obligimin e përkujdesjes për punëtorët përkatës dhe zbatimin e masave të nevojshme konform rekomandimeve të IKShPK-së. Menaxhmenti edhe një herë u bënë thirrje të gjithë punëtorëve të KEK-u, që të vazhdojnë t'i respektojnë rekomandimet e lëshuara nga IKShPK-ja, duke pasur në konsideratë se rreziku nga COVID-19 ende nuk ka kaluar dhe çdo moskujdes paraqet rrezik për të gjithë punonjësit e korporatës në tërësi!", ka njoftuar KEK-u.

EPOKA
ERE **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 4 QERSHOR - Dhjetëra punëtorë të Korporatës Energjetike të Kosovës (KEK) kanë protestuar për kthimin në punë të ish-drejtorit ekzekutiv të kësaj korporate, Njazi Thaçi, i cili është shkarkuar nga bordi i përkohshëm i KEK-ut. Kjo protestë, e cila është organizuar nga Këshilli Iniciues i Punëtorëve të KEK-ut, është mbajtur para mensës së termocentralit "Kosova B", ku protestuesit janë përplasur me sigurimin e KEK-ut.

Faket Selmani nga ky këshill ka kërkuar nga bordi i përkohshëm i KEK-ut dhe kryeministri Avdullah Hoti që ta kthejnë në punë Njazi Thaçin pasi, siç ka thënë ai, ka qenë kryehero i kësaj ndërmarrje me performancën pozitive që ka

treguar. Pas kësaj proteste, ai është shoqëruar në polici së bashku me Muhamet Selamin si organizator të protestës. Policia e Kosovës në fillim të ngjarjes nuk ishte e pranishme, por pas 20 minutave aty ishte parë edhe njësi speciale e policisë. Ndërsa Sindikata e re e Punëtorëve e Korporatës Energjetike të Kosovës i ka dërguar një shkresë ushtrueses së detyrës së drejtorit të bordit të përkohshëm, duke ia bërë me dije se nuk qëndrojnë prapa protestës e cila është organizuar të enjten. Kjo sindikatë ka theksuar se nëse i bëhet e padrejtë do të reagojnë në rrugë të lejuar sindikale. Me këtë rast, në reagimin e kësaj sindikate është thënë se punëtorët e KEK-ut janë duke e rrezikuar veten në këtë kohë të pandemisë.

Kujtojmë së më 24 prill bordi i përkohshëm i KEK-ut një ditë

Tahiri: Do të merrem me vonesat e 170 eurove për punëtorët e sektorit privat

PRISHTINË, 4 QERSHOR - Zëvendëskryeministri i parë i Qeverisë së Republikës së Kosovës, Besnik Tahiri, ka folur në lidhje me vonesat e pagesave prej 170 eurosh për punëtorët e sektorit privat, ku rreth 20 mijë përfitues ende nuk i kanë marrë mjetet nga pakoja emergjente. Tahiri ka thënë se kjo çështje është në prioritetin e qeverisë së re dhe personalisht ai do të merret me këtë çështje. "Çdo vendim shtetëror është obligim shtetëror. E kemi parasysh shqetësimin e madh qytetar për vonesat. Ajo që mund të them është se ekzekutimi dhe përmirësimi do të bëhet sa më parë. Shpresoj shumë, qysh pasdite, pas agjendës në terren, do të ulemi me kryeministrin Hoti, ministrin e Financave, Hykmete Bajrami e të shohim se ku ka mbetur kjo çështje që është shqetësim i madh qytetar. Ajo çfarë mund të them

është se duhet të jemi realistë dhe mos të premtojmë data, por me programin qeveritar njerëzve t'ua kryejmë obligimet", ka thënë Tahiri për "Radio 1".

Më tutje, Tahiri ka thënë se nuk ka dashur ta komentojë debatin që është zhvilluar në Kuvendin e Kosovës mbi keqpërdorimet e mundshme të ish-qeverisë së kaluar gjatë pandemisë, por ka reaguar te gjesti i mospranisë së tyre në pranim-dorëzim të detyrave qeveritare nga ana e ish-kryeministrit Albin Kurti. "Nuk do të doja të merresha tani me këtë çështje. Ne shumë shpejt do ta kemi programin tonë qeveritar para deputetëve e ku përfshihet edhe pandemia dhe pas-pandemia. Ajo çfarë doja të thosha është se për kujtesën qeveritare nuk ka qenë me vend mosdorëzim-pranimi i detyrave. Megjithatë, mbetet në zgjedhjen e Kurtit", ka thënë Tahiri.



Me iniciativën e Bahtirit të shtunën do të pastrohet Liqeni Akumulues në Mitrovicë

MITROVICË, 4 QERSHOR (ER) - Kryetari i Komunës së Mitrovicës, Agim Bahtiri, së bashku me nënkryetarin Faruk Mujka, të enjten kanë pritur në një takim sekretarin e Shoqatës së Peshkatarëve Sportiv Rekreativ (ShPSR) "Ibri", Arif Kadriu. Në këtë takim është diskutuar lidhur me mirëmbajtjen dhe pastrimin e Liqenit Akumulues në Suhadoll të Mitrovicës, me ç'rast janë marrë vesh që Komuna e Mitrovicës në bashkëpunim me Shoqatën e Peshkatarëve Sportiv Rekreativ

të fillojnë pastrimin e këtij Liqeni, duke larguar në mënyrë të tërësishme barishtet dhe papastërtitë e tjera të cilat janë grumbulluar përgjatë tyre. "Me këtë rast ky aksion i përbashkët nga Komuna, KRM 'Uniteti' dhe ShPSR 'Ibri' do të zhvillohet më 06.06.2020 (ditë e shtunë), duke filluar nga ora 10:00. Andaj ftojme të gjithë qytetarët vullnetarë të cilët janë të interesuar të jenë pjesë e këtij aksioni të na bashkëngjiten", ka njoftuar Komuna e Mitrovicës.



Asfaltohet një rrugë dhe hapen dy të tjera në fshatrat e Malishevës

MALISHEVË, 4 QERSHOR (ER) - Në tri fshatra të Komunës së Malishevës është asfaltuar një rrugë dhe ka filluar hapja e dy rrugëve të tjera të cilat së shpejti pritet të përfundojnë. Në fshatin Temeqinë është asfaltuar një rrugë, ndërsa ka filluar hapja dhe ndërtimi i dy rrugëve të tjera, njëra në Kërvasari dhe tjetra në Lladrovc. Punimet në këto rrugë të enjten i kanë parë nga afër

kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj dhe drejtori i Urbanizimit, Islam Vrenezi ku, krahas inspektimit të punimeve, janë takuar edhe me banorë, të cilët i kanë uruar për këto rrugë të reja në të tri fshatrat. "Këto janë planifikime të cilat jemi duke i realizuar dhe të gjitha këto rrugë kanë rëndësi të madhe për banorët e lagjeve në këto tri fshatra", ka thënë Begaj. Ndërsa drejtori i Drejtorisë së

Urbanizimit, Islam Vrenezi, ka bërë me dije se këto rrugë janë investim i kësaj komune. "Këto rrugë mundësohen nga buxheti komunal i Malishevës, ndërsa rrugët kanë këto gjatësi: në Temeqinë rruga e asfaltuar është e gjatë 420 metra, rruga që ka filluar të hapet në Kërvasari është e gjatë 680 metra dhe ajo në Lladrovc është e gjatë 750 metra", ka thënë ai.

Ndihmohen 140 familje skamnore në Kamenicë me pako ushqimore dhe higjienike

KAMENICË, 4 QERSHOR (ER) - Komuna e Kamenicës, në bashkëpunim me organizatën joqeveritare "Network of Peace Movement" (NOPM), ka bërë shpërndarjen e pakove ushqimore dhe higjienike për 140 familje në nevojë për shkak të situatës aktuale me pandeminë Covid-19. Kjo organizatë ka mbështetur familjet në nevojë, grupet e marginalizuara të shoqërisë, të kthyerit dhe familje nga komunitet shumicë dhe joshumicë, përfshirë gratë, të moshuarit dhe fëmijët e të gjitha komuniteteve që jetojnë në komunën e Kamenicës,

Komuna e Kamenicës me mundësitë që ka u ka dalë në ndihmë gjatë periudhës së pandemisë të gjithë atyre që kanë pasur nevojë. Aksioni humanitar është përmbyllur brenda katër ditëve të punës, ku janë përfshirë vullnetarë

me furnizime të nevojshme ushqimore dhe pako higjienike. Nën kryetari për komunitete në Komunën e Kamenicës, Bojan Stamenkoviç, së bashku me organizatën NOPM dhe me Qendrën për Punë dhe Mirëqenie Sociale, me ndihmën e Kryqit të Kuq vendor kanë përgatitur listën e përfituesve, duke identifikuar rastet në nevojë. Stamenkoviç ka thënë se



nga komuna të cilët së bashku me stafin e NOPM kanë siguruar transportin për shpërndarjen e 140 paketave për përfituesit. Totali i familjeve të ndihmuara është: 59 familje shqiptare, 45 familje serbe, 32 familje rome dhe 4 familje gorane. Ndërsa përfitues në bazë individuale janë gjithsej 484 individë, nga të cilët 225 shqiptarë, 111 serbë, 128 romë dhe 20 goranë.

Gashi: Çdo lehonë e Obiliqit do t'i marrë nga 150 euro



OBILIQ, 4 QERSHOR (ER) - Kryetari i Komunës së Obiliqit, Xhafer Gashi, ka nënshkruar një vendim nëpërmjet të cilit çdo grua lehonë të kësaj komune do t'i ndahet një shumë prej 150 eurosh në kuadër të subvencioneve të Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale (DShMS).

Me këtë rast, Gashi ka theksuar se çdo kategori e shoqërisë do ta ketë përkrahjen e nevojshme institucionale, sidomos "gratë që janë shtylla kryesore e familjes dhe shtetit!" "Sot kam nënshkruar vendimin përmes të cilit çdo grua lehone të komunës së Obiliqit do t'i ndahet një shumë prej 150

eurosh në kuadër të subvencioneve të Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale (DShMS). Jam i përkushtuar që çdo kategori e shoqërisë sonë ta ketë përkrahjen e nevojshme institucionale, sidomos për gratë që janë shtylla kryesore e familjes dhe shtetit!", ka thënë Gashi.

Njerëzit e mirë të luftës (II)



Bedri ISLAMI

Në afërsi të Parisit ka jetuar prej shumë vitesh një familje e njohur, saktësisht familja më e njohur për të gjitha strukturat ilegale, e cila në një formë ose në një tjetër ka pritur, mbështetur dhe bashkëpunuar me të gjithë emrat e njohur të lëvizjeve ilegale. Ka pasur raste kur në dhomat e pakta të shtëpisë së saj kanë fjetur me ditë me shumë se 20 veta dhe kjo për të ka qenë e natyrshme. Megjithatë, pritja, dashamirja dhe përcjellja e njerëzve është në traditën e një populli të lashtë, por ajo familje ka bërë edhe më tej se kaq.

Le të themi emrat e tyre, për t'i njohur edhe të tjerët, sepse, sapo mund të kenë lexuar fjalitë e para, gjithkush nga ilegalët e atëhershëm e di se është fjala për bacën Ibush Bytyqi dhe gruan e tij, Sadijen. Këta shin dy njerëz, dhe pas tyre e gjithë një familje, krejtësisht e angazhuar për lirinë e Kosovës. Dy njerëz gjithnjë në lëvizje, kudo që bëhej një demonstratë, kudo që nëshkruhej një peticion, kudo që bëheshin organizimet e para, me shtëpinë e hapur, ditën dhe natën, me ndjenjën e detyrës si gjë të shenjtë dhe të çmuar. Gjithsecili që ka qenë tek ata e di përkushtimin e tyre.

Por, unë do të them një rast që ka lidhje me kujdesin për një shok që nuk është më dhe për një emër të jashtëzakonshëm njëkohësisht, Jashar Salihun. Jashari tashmë nuk është më mes nesh. Sa ishte lufta, ai e mposhti sëmundjen e tij, e përballoi atë, arriti të shohë edhe një herë Botushën, vendlindjen e tij të dashur, të shëtisë i lirë në rrugët e Prishtinës dhe tashmë sëmundja fillojë ta mposhtë atë njeri të jashtëzakonshëm. Pas analizave të para në një spital të Zvicrës dhe pas tentimit për t'u operuar aty, çuditërisht nga një mjek sllav, me ndërhyrjen e shokëve në Prishtinë, u bisedua me kryeadministratorin e atëhershëm të Kosovës, zotit Kushner, dhe u dërgua në një nga spitalet e njohura të Parisit. Disa ditë i duhej të qëndronte për të pritur shtrimin në spital, pas analizave të para. Ishte tepër e natyrshëm që do të shkante në një familje të njohur dhe po ashtu natyrshëm shkoi tek baca Ibush. Sëmundja ishte e rëndë dhe nuk dua të kthehem tek ajo; por gjithçka që ka qenë e mundur të bëhet për Jashën në një shtëpi shqiptare, e kanë bërë ata njerëz të urtë dhe të mirë, baca Ibush dhe Sadija. Ditë dhe net qëndruan mbi kokën e tij, i kishin

lëshuar njëren nga dhomat e pakta të shtëpisë dhe rrinin mbi të, si mbi vëllanë e tyre. E kishin më tepër se kaq: kishin bashkëluftuar për shumë vite së bashku për një ditë më të mirë të Kosovës. Kishin duruar shumë gjëra, kishin hequr në jetë, dhe tani nuk bënte kurrsesi të ikte njëri prej shokëve; njëri nga më të mirët. Në njëren nga ditët e sëmundjes së tij ne shkuam së bashku me bacën Rifë (Rifat Jashari) ta shihnim. Ishte disi më mirë. Mendohej se fuqia e shpirtit dhe e fizikut të tij mund të mposhte sëmundjen. Ashtu me zërin e paktë, disi i lodhur, i thoshte bacës Rifë se gjëja që i kishte mbetur në zemër ishte në faktin se nuk arriti të luftonte krah Adem Jasharit. Dy njerëzit e mirë ishin përsëri aty. Jasha na thoshte, se ata kishin heshtur, se askush nuk mund të ishte kujdesur ashtu për të. Ndërsa unë e dija se kjo ishte në natyrën e tyre të mirë.

Një rast tjetër: Përderisa baca Ibush kishte më se njëzet vite veprimtari politike ilegale, në Londër njihet emri i një vajze të re, e cila nuk kishte qenë as atëherë e as më vonë në lëvizjet ilegale. Motra e saj, Adelina Toplica, ishte nënkryetare e degës së LPK-së në Angli, por ajo nuk e bëri këtë për motrën e saj. Ta tregojmë thjeshtë ngjarjen, ani pse disa gjëra është e logjikshme se duhen nënkuptuar. Kjo ka ndodhur ne tetorin e vitit 1998. Pas një bisede telefonike me Xhavit Halitin, ishte e domosdoshme të bëhej një mobilizim i jashtëzakonshëm në Perëndim për të mbështetur një detyrë të Shtabit të Përgjithshëm. Gjithçka duhej bërë brenda një jave. Më shumë se gjithçka kjo lidhej edhe me disa nga veçoritë e punës së saj. Duhej siguruar diçka tepër e vlefshme për të, dhe këtë e morën përsipër në Angli. Nuk ishte armë ose diçka tjetër, por ajo kishte lidhje me fuqizimin e propagandës dhe të krijimit të strukturave mediatike në luftë. Por, ishte vështirë. Duheshin bërë punë të jashtëzakonshme në pak kohë. Pleurat Sejdiu, që atë kohë drejtonte LPK-në Angli dhe përfaqësoonte politikisht Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës, së bashku me dhjetëra njerëz rreth tij, bënë atë që ishte e pabesueshme për t'u bërë. Tani gjithçka kishte mbetur për të shkuar drejt vendit të caktuar dhe këtë e mori përsipër një vajzë e re, e imtë, me emrin Alije Toplica, e cila, së bashku me një grup shokësh e shoqesh ishin të organizuar në fondin "Vendlindja thërret". Nuk ka qenë e lehtë për t'u bërë një gjë e tillë, ishte e mundshme që ajo vajzë e re të kishte pasoja më shumë se sa mund të mendohej, të kalonte përmes njëmijë e një vështirësish dhe të gjitha këto ajo

i dinte. Megjithatë, ajo e mori përsipër krejt normalisht dhe e realizoi. Së bashku me Sejdi Gegën, që po e priste në vendin e caktuar, më patën telefonuar. Ndjeva një lehtësim të jashtëzakonshëm; tashti ishte e mundshme që të ndjehej edhe zëri i çlirimtarëve. Një pjesë të madhe të kësaj pune e kishte mbartur një vajzë e zakonshme, e cila ishte kthyer po atë ditë në vendin e saj dhe po atë mbrëmje kishte shkuar në punën e saj të zakonshme, megjithëse kishte pasur para vetes një punë të jashtëzakonshme.

Kërkesa e vetme e ambasadorit shqiptar në Londër

Sa herë që kam menduar për njerëzit e mirë të luftës, kam menduar po ashtu edhe për ndihmesën e pabujshme të disa përfaqësuesve të shtetit shqiptar në Perëndim. Nuk e di në se e kanë pasur në platformën e ardhur nga Ministria e Punëve të Jashtme, por një pjesë e tyre, sidomos në shtetet perëndimore, kanë pasur një afërsi të jashtëzakonshme me strukturat e luftës. Ashtu si ka pasur raste, që edhe kur nuk kanë pasur lidhje të drejtpërdrejta, me fjalën e tyre, në vendet ku kanë ushtruar aktivitet, kanë bërë gjëra të vlefshme, si për shembull ambasadori i Shqipërisë në Pragë, artisti i popullit, regjisori Piro Milkani. Por unë desha të sjell vetëm shembullin e një ambasadori, tepër të dhënë, i cili, shpesh herë, ashtu si rastësisht, tejkalonte edhe ndonjë kompetencë të dhënë nga vetë shteti amë. Desha të tregoj për ambasadorin shqiptar në Londër, zotit Agim Fagu. Mendoj edhe tani, si para shumë viteve, se për strukturat e lidhura me Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës ka qenë një fat i bardhë që kanë pasur lidhje të drejtpërdrejta dhe mundësinë të bashkëpunojnë me përfaqësues të shtetit shqiptar si Agim Fagu në Londër apo Bashkim Zeneli në Gjermani.

Agim Fagu e shprehte gjithçka haptas kur ishte fjala për Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës. Jo radhë herë ai "hiqte togën" e ambasadorit, dhe ishte si gjithnjë njeriu i mirë. Kishte lidhje tepër të mira, ndoshta të përditshme me Pleurat Sejdiun, përfaqësuesin politik të UÇK-në në Londër, por edhe drejtues i degës së LPK aty. Pleurati konsultohet shpesh herë me të, dhe jo radhë fillimi i kontakteve të tij me përfaqësuesit e lartë politikë, jo vetëm të shtetit ku jetonin, por edhe me të tjerë, ishin pikërisht aty, në selinë e ambasadës shqiptare në Londër. Aty janë bërë edhe disa nga fillimet e takimeve me përfaqësues të mediave të rëndësishme botërore, dhe herë

pas here, zoti Agim Fagu i organizonte këto si rastësisht.

Pasi fronte një personalitet të rëndësishëm politik për një bisedë, një, mbrëmje ose një koktej, ai i propozonte, në se dëshironte, të organizonte një takim edhe me përfaqësues të UÇK-së, pasi edhe ata "kishin ndodhur" diku aty, përsëri rastësisht. Për të gjitha këto ambasada bënte shpenzime të paparashikuara. I pata thënë Pleuratit, që, në se ambasada shqiptare organizon takime të tilla, thjeshtë për punën që bënim atëherë, ai, miqësisht, le të bisedonte me Agimin dhe t'i afronte, qoftë edhe një ndihmë modeste për ambasadën. Pleurati kishte provuar diçka, por kishte marrë një përgjigje jo edhe aq "miqësore". Zoti Fagu nuk kishte pranuar asgjë, ai kishte gjithnjë shqetësimin si mund të bënte më shumë se aq.

Dhe, kur shkoja në Londër, në takimet me të, ose me bashkatdhetarët, ai ishte gjithnjë i pranishëm, zhvishej nga posti i tij, fliste hapur se duhej ndihmuar lufta, se nuk duhej kursyer asgjë për djemtë e vashat që luftonin. Fliste qartë, ajo ishte bindja e tij dhe si njeri ai nuk kishte përse, mes vëllezërve e motrave, të fshihte veten. Në fundin e nëntorit 1998, kur ishim të ftuar së bashku me Ramiz Lladrovcin dhe Lulëzim Jasharin, nga bashkësia shqiptare e Londrës për ditën e Flamurit, që ishte njëkohësisht edhe ditëlindja e atit të Lulit, Adem Jasharit, pas aktiviteteve jashtëzakonisht të bukura që u bënë, zoti Fagu na ftoi në shtëpinë e tij. Unë kisha qenë edhe herë të tjera, sepse njiheshim prej vitesh dhe kishim miq të përbashkët. Shtëpia e ambasadorit shqiptar, sidomos dhomat e dy fëmijëve të tij, djalë dhe vajzë, të dukeshin si dhomat e Kosovës. Gjithçka aty fliste për ushtrinë Çlirimtare të Kosovës. Në mure ishin fotot e shumta të Ademit, Hamzës, bacës Shaban, emblema e UÇK-së, e fondit "Vendlindja thërret", nga mganetofoni dëgjoheshin vetëm këngët që sapo kishin dalë për luftën që zhvillohej, në TV kishin incizimet e reja të TVSH, gjithçka ishte përfshirë aty nga lufta që bëhej në Kosovë. Nga i ati kishin marrë edhe fëmijët, por tashmë, ashtu vrullshëm, si të rinjtë, megjithëse në fillimin e rinisë së parë, ato donin më shumë.

Ramizin dhe Lulëzimin i pritën si vëllezërit e tyre, kishin dëshirë të dinin sa më shumë për Adem Jasharin, Hamzën, për Fehmiun, për fillimet e luftës, pra për gjithçka.

Disa kohë më parë, një bashkatdhetar i yni, përmes mikut tim Hamit Xhema, kishte dhuruar në fondin "Vendlindja thërret" rreth 100 orë (nuk e di saktësisht), të cilat në mesin e tyre kishin emblemën e Ushtrisë

Çlirimtare të Kosovës.

Ishte vendosur që orët të dhuroheshin në takime me personalitete të ndryshme, familjeve të dëshmorëve, luftëtarëve. Një orë të tillë i kishim dhuruar së bashku me bacën Rifat Jashari kryeministrit të atëhershëm të Shqipërisë, Pandeli Majko, ia kisha dhuruar zonjës Bianka Jagger, e dërguara e Departamentit të Shtetit, ish grua e këngëtarit të njohur Mikke Jager, të cilën e kisha takuar pikërisht në zyrën e Agimit; një orë të tillë, i dhuroam atë ditë edhe ambasadorit shqiptar Agim Fagu. Ishte e vetnja gjë që ai pranoi, por disa më pas, duke biseduar në telefon me të, ai bëri edhe kërkesën e tij të vetme. Çfarë kishte ndodhur që ky njeri, i cili nuk kishte pranuar askurrë, qoftë edhe për ambasadën që drejtonte, që merrte përsipër edhe shpenzimet e takimeve që organizonte për strukturat e luftës, të bënte një kërkesë. Çfarë kërkonte?

Në familjen Fagu, pasi kishin një orë me emblemën e UÇK-së kishte filluar edhe "shërr". Të dy fëmijët, që ishin në një nga shkollat më të njohura të Londrës, kërkonin me çdo kusht të vendosnin në dorë pikërisht këtë orë. Ishte vendosur që një ditë ta mbante njëri dhe ditën tjetër, ta mbante tjetri. Por herë pas here, qoftë djali, qoftë bija e Agim Fagut, kur zgjoheshin më herët, e shkelnin radhën dhe e merrnin orën me vete. Ishte një shërr thuajse i përditshëm dhe me këtë orë ata mburreshin tek shokët dhe tek shoqet e tyre londinezë. Duhej shprishur ky shërr dhe nuk ishte gjetur rrugë tjetër, veçse të prishte traditën e tij dhe të bënte një kërkesë: ju lutem më duhet edhe një orë tjetër. Jam i gatshëm të bëj pagesën, por shërrin duhet ta shuaj. Ata që i njihnin fëmijët e Agimit e dinin se ky ishte një shërr i vërtetë. Mbjaj mend, se kur ishim në një takim me bashkatdhetarët në Londër, bija e zotit Fagu po rrinte një radhë pas nesh. Folësi i parë në atë mbrëmje po tregonte gjendjen në Kosovë, por ende nuk e kishte përmendur UÇK-në. Shkuan disa minuta bisedë dhe më në fund ai tha se njerëzit po bashkohen rreth UÇK-së. Bija e zotit Fagu tha lehtësisht, por me zë të lartë: "Po thuaje të shkretën se këtë presim". Pra nuk ishte pozë, nuk ishte dëshirë rinore për të pasur diçka të veçantë, ishte shumë më tepër se kaq, ishte edhe përkushtimi i gjyshit të tyre Besim Fagu, edhe i atit të tyre Agim Fagu, por edhe nënës së tyre.

Ky ishte i vetmi rast që një ambasador, i cili nuk përtonte të bënte gjithçka për luftën, kërkoji diçka. Në fund të fundit, edhe kërkesa e tij kishte lidhje me luftën.

Turqia planifikon rikthimin e fluturimeve me 40 shtete në qershor

Turqia planifikon të rikthejë fluturimet ndërkombëtare me rreth 40 shtete në muajin qershor, dhe deri më tani ka arritur marrëveshje preliminare me 15 shtete, ka thënë Ministri turk i Transportit, Adil Karaismailoglu. Turqia ka mbyllur kufijtë në kuadër të masave për të luftuar koronavirusin e ri.

Fluturimet e brendshme janë rikthyer të hënën në disa provinca, teksa Ankaraja ka lehtësuar kufizimet pas rënies së numrit të infektuarve.

Karaismailoglu ka thënë se fluturimet do të rikthehen në pesë faza në muajin qershor, duke shtuar se Turqia është duke zhvilluar bisedime me 92 shtete

për rikthim të udhëtimeve në mënyrë të sigurt.

"Ne besojmë se kemi lënë mbra-pa një pikë të rëndësishme në betejën kundër virusit global. Tani duhet të vazhdojmë lidhjet tona globale ashtu sikurse tregtinë", ka thënë ai në një deklaratë të shkruar.

Gjermania ka thënë të mërkurën

se është duke biseduar me Ankaranë për të rishikuar kufizimet në udhëtime, mirëpo është duke pritur një rekomandim nga Bashkimi Evropian.

Në gjithë Turqinë, me koronavirus janë infektuar më shumë se 165,000 persona.

Prej tyre, 4 609 kanë vdekur.



Shefi i Pentagonit sfidon presidentin Trump për përdorimin e forcave aktive në protesta

Ndërkohë që vazhdojnë protestat në qytetet kryesore amerikane, Sekretari i Mbrojtjes Mark Esper tha mbrëmë se nuk mbështet përdorimin e forcave aktive ushtarake për të penguar protestuesit. Kjo deklaratë e vë Shefin e Pentagonit në kundërthënie me Presidentin Trump, i cili ka kërcënuar se do të dërgojë trupa për të shtypur protestat që vazhdojnë prej një jave, të nxitura nga vdekja e një afrikano-amerikani gjatë arrestimit nga një polic i bardhë. Korrespondentja e Zërit të Amerikës në Shtëpinë e Bardhë Patsy Widakuswara njofton:

Protestat, në pjesën më të madhe paqësore, vazhduan mbrëmë në qytetet kryesore amerikane ku dhjetëra mijëra vetë nuk përfillën urdhrat për ndalim-qarkullim dhe rrezikun nga koronavirusi, për të shprehur revoltim për racizmin dhe dhunën policore.

Në fillim të javës, Presidenti Trumë kërcënoi se do të

përdorte një ligj që i jep atij mundësinë të autorizojë dërgimin e forcave aktive ushtarake për të shtypur protestat, pa parapëlqimin e guvernatorëve.

Në sfidë ndaj kërcënimit të presidentit, Sekretari i Mbrojtjes Mark Esper tha se forcat aktive ushtarake duhet të përdoren vetëm në rastet më urgjente dhe ekstreme:

"Nuk jemi aktualisht në një nga këto situata. Nuk mbështes aktivizimin e Ligjit të Kryengritjes," tha zoti Eper.

Të mërkurën në mëngjes, Sekretari Esper u dha urdhër 200 ushtarëve në shërbim aktiv të ktheheshin në bazë pas dy ditë demonstratash paqësore në Uashington, por e anuloi vendimin brenda pak orësh pas një takimi në Shtëpinë e Bardhë.

Sekretari Esper po ashtu u distanca nga vizita e Presidentit Trump në një kishë pranë Shtëpisë së Bardhë, ku ai pozo për gazetarët me biblën



në dorë. Fotografia nxiti revoltim dhe kritika të forta, pasi policia përdori gazën lotsjellës dhe granata zhurmuese për shpërndarjen e turmës. Ky akt dhe reagimi ndaj protestave kanë dëmtuar popullaritetin e presidentit.

"Jemi në mes të protestave më të ndezura që kemi parë që në vitet 1960. Kjo nuk është atmosferë e mirë për një president që po konkurren për rizgjedhje. Do t'i duhet të bëjë shumë gjëra që të rikthejë normalitetin, pasi për momentin nuk është në avantazh," thotë Larry Sabato i Universitetit të Virxhinias.

Trazirat filluan pas vdekjes së George Floyd, një afrikano-amerikan i cili vdiq pasi një polic i bardhë e mbajti me gjurin në qafë për më shumë se

8 minuta.

Ish-presidentët amerikanë që janë gjallë sot, përfshirë Jimmy Carter, George W Bush dhe Bill Clinton kanë dënuar aktet që çuan në këtë vdekje.

Në një diskutim të hapur të zhvilluar online, ish-presidenti Barak Obama u bëri thirrje kryebashkiakëve të rishikojnë përdorimin e forcës në qytetet që drejtojnë:

"Kur shikon protestat sot, ato përfaqësojnë një përzgjedhje demografike shumë më të gjerë të Amerikës që e ndjeu të nevojshme të bënte diçka si rezultat i padrejtësive që janë vërejtur," tha ish-presidenti Obama.

Protestat kanë hedhur dritë mbi një sistem padrejtësish racore në këtë vend.

"Revoltimi lidhet me kushtet e

strehimit, me mundësinë për punësim, me gjendjen në shkollat publike, me ritmet e burgosjes. Nuk ka të bëjë vetëm me reagimin e policisë. Gjithë këta njerëz kanë dalë sot sepse ka diçka rrënjësisht problematike, jofunksionale në këtë sistem për sa u përket miliona amerikanëve," thotë Peniel Joseph me Universitetin e Teksasit.

Policia që mbajti të mbrerthyer me gjurin tek qafa afrikano-amerikanin George Floyd është akuzuar tani me vrasje me dashje të gradës së dytë, që përkufizohet si vrasje e qëllimtare por pa paramendim. Tre oficerët e tjerë që qëndruan pasivë në skenën e ngjarjes janë akuzuar për ndihmë dhe mbështetje të një vrasjeje të qëllimtare.



Autopsia: George Floyd ishte me koronavirus

Afro-amerikani George Floyd, vdekja e të cilit në duart e Policisë shkaktoi një valë protestash në të gjithë SHBA, ka qënë i infektuar me koronavirus disa javë para vdekjes së tij.

Një raport i autopsisë 20-faqëshe të lëshuar nga Zyra e Mjekësisë Ligjore të qarkut Hennepin tregon se ai kishte koronavirusin që në 3 prill.

Sidoqoftë, për shkak se kodi gjenetik i virusit mund të mbetet në trupin e dikujt me javë, ka të ngjarë që ai të ishte asimptomatik në kohën e vdekjes së tij, por tregonte mbingarkesë në krahasim me infeksionin e mëparshëm, thuhet në raportin mjekësor.

Dr. Michael Baden, një ish-mjek ligjor i Nju Jorkut, i cili ishte një nga dy mjekët që kreu

një autopsi private për Floyd, i tha New York Times se zyrtarët e qarkut nuk e kishin njoftuar atë që Floyd ishte testuar pozitiv me Covid-19.

"Nëse e bëni autopsinë dhe është pozitive për koronavirusin, është e zakonshme t'u tregoni të gjithëve që do të jenë në kontakt me trupin. Do të tregojë më shumë kujdes," tha ai.



Tetë perandorët më të përgjakshëm të historisë së Romës

Ata shpesh përshkruhen si të pamëshirshëm dhe të etur për gjak, të famshëm për mbretërimin e tyre tiranike. Historiani Sean Land na rrëfen për tetë perandorët më të përgjakshëm të Romës së Lashtë, nga perandori ilir Diokleciani tek Neroni

Kemi dëgjuar për shumicën e perandorëve romakë. Disa nga ta i njohim si të çmendur, të këqij e shumë të rrezikshëm. Në fakt, siç historianët tregojnë, shumë nga perandorët e listës së mëposhtme kanë qenë administratorë të aftë. Disa perandorë, si Neroni apo Domiciani, kanë kaluar në histori si modele tiranësh paranojakë, ndërsa të tjerë, si Diokleciani, ishin administratorë të aftë që bënë një qeverisje të mirë. Edhe nën sundimin e perandorëve më të këqij, Roma vazhdoi të funksiononte, por përfshirja në jetën publike mund të kthehej në një biznes të rrezikshëm.

Tiberi (sundoi në vitet 14-37)

Tiberi ishte pasardhësi i Augustit, edhe pse Augusti nuk donte që Tiberi ta pasonte atë, por ishte vdekja e parakohshme e nipërve të tij, Gaius dhe Lusius, që bëri që Tiberi të merrte fronin. Tiberi ishte komandant ushtarak i zoti, dhe respektonte autoritetin e senatit. Megjithatë, për të pati një opinion të zymtë dhe dyshime që e çuan në grindje të ashpër me Agrippina-n, të venë e nipit të tij hero të luftës. Shumë persona që donin të arrinin pushtet Tiberi i arrestonte dhe ekzekutonte. Dyshimet mbi të kishte kudo dhe nga kushdo rreth tij. Ai u tërhoq në ishullin e Kaprit dhe ringjalli akuzën e lashtë të tradhtisë, duke e përdorur atë për të dënuar të gjithë të dyshuarit me vdekje. Historianët romakë na rrëfejnë një pikturë të jetës së Tiberit atje si një grabitqar i çoroditur seksual.

Gaius ose Kaligula (sundoi në vitet 37-41)

Gaius është i njohur për një sërë veprimesh të çuditshme, si shpallja e luftës në det dhe shpallja e vetes zot. Mbretërimi i tij ishte premtues në fillimet e veta, por pas një periudhe të vështirë që kaloi për shkak të një sëmundjeje, ai u bë paranojak, gjë që e çoi në sjellje të çrregullta, ku përfshihet këtu

edhe incesti me motrën e tij, Julia Drusilla. Gaius kënaqej nga fakti që poshtëronte Senatin, duke deklaruar se ai mund të bënte konsull kë të dëshironte, madje edhe kalin e tij. Gaius ishte i etur për të krijuar kredencialet e tij ushtarake, edhe pse me fushatën e tij në Gjermani nuk arriti shumë dhe pushtimi i tij i dështuar i Britanisë u kthye në një luftë me zotin e detit, Neptunin. Thuhet se ai kishte urdhëruar trupat e tij



të sulmonin dallgët me shpatat e tyre. Gaius e shpalli veten zot dhe përdorte statusin e tij hyjnor për të vendosur monarki absolute në Romë. Ai ndoqi shembullin e Tiberit duke përdorur gjykimet e tradhtisë për të eliminuar armiqtë, realë e imagjinarë. Pas sjelljeve të tij foshnjërore, ndaj tij u organizua një vrasje. Dhe mendohet që Gaius të ketë protestuar se nuk mund të vritej pasi ishte një Zot i pavdekshëm, gjë që nuk rezultoi e tillë.

Neroni (sundoi në vitet 54-68)

Neroni është një perandor romak të cilin ne të gjithë duam ta urrejmë, dhe jo pa arsye. Ai ishte një administrator i zoti, dhe rrethohej nga njerëz të aftë, përfshi dhe tutorin e tij – shkrimtarin Seneka. Megjithatë, ishte një vrasës i pamëshirshëm, duke filluar që me vrasjen e gjysmë-vëllait të tij, me të cilin supozohej të ndante pushtetin. Duke vazhduar me

bashkëshorten e tij, Oktavia, të cilën e braktisi për të dashurën Poppaea, dhe më pas e ekzekutoi për tradhti bashkëshortore. Ndoshta për t'i bërë qejfin të dashurës së tij ai vrau dhe nënën e vet, që pas një komploti të shkuar keq për ta mbytur me një varkë, e rrahën për vdekje. Më vonë ai vrau dhe të dashurën pas një çasti zemërimi, ndërkohë që ajo ishte shtatzënë dhe priste fëmijën e tij. Pasioni i madh i Neronit për muzikën dhe poezitë e veta, bëri që ai të detyronte senatorët të uleshin e të dëgjonin recitalet e tij të pafundme e të kota. Neroni gjithashtu u urrye shumë pasi ndërtoi shtëpinë e tij të artë e të madhe në rrënojat e asaj që më parë ishte zona publike e Romës. Ai persekutoi një numër të madh të krishterësh dhe këmbëngulja e tij fëmijërore për të fituar famë në Lojërat

Olimpikë në Greqi, bëri që perandoria të përçahet. Neroni u rrëzua nga një revoltë ushtarake.

Domiciani (sundoi në vitet 81-96)

Domiciani ishte djali më i ri i gjeneralit Vespasian, i cili kishte dalë nga kaosi pas rënies së Neronit dhe kishte vendosur stabilitetin në jetën publike romake. Domiciani nuk trashëgoi asgjë nga sharmi i babait të tij, dhe kishte dyshime të mëdha nga njerëzit përreth tij, gjë që e çoi në paranojë, mbase edhe për shkak të arratisjes së tij dredharake gjatë luftës civile për rrëzimin e Neronit. Shumë qytetarë u vranë për dyshime komplotesh kundër tij, përfshi edhe 12 konsuj dhe dy kushërinj të tij. Sundimi i Domicianit u bë edhe më autokratik, dhe kërkoi që të trajtohej si Zot. Domicianoani u kthye kundër filozofëve, duke dëbuar nga vendi shumë prej tyre. Domiciani u rrëzua pas një

komploti të organizuar nga gruaja e tij Domicia, dhe më pas u godit me thikë nga një shërbëtor i pallatit. Disa historianë mendojnë se tirania e Domicianit ishte e ekzagjeruar, ndërsa të tjerë e kanë krahasuar atë me Sadam Hysenin e ditëve tona.

Komodo (sundoi në vitet 180-192)

Komodo ishte perandori i luajtur nga aktori Joaquin Phoenix në filmin Gladiatori. Komodo ishte një ndjekës i apasionuar i betejave të gladiatorëve, madje dhe vetë ai luftoi në arenë, shpesh herë i veshur si Herkuli, dhe që më pas e shpalli veten Herkuli romak. Komodo ishte djali i perandorit filozof Mark Aurelit. Edhe pse skena e filmit ku Komodo vret të

Mark Aurel Antoni e vrau atë. Ai i trajtonte në mënyrë brutale kundërshtarët, dhe shfarosi të gjithë përkrahësit e Getës. Mark Aurel Antoni njihet për kompleksin e tij madhështor të banjove në Romë që mbanin emrin e tij, dhe për dhënien e shtetësisë romake për të gjithë njerëzit e lirë brenda perandorisë. Ai përpigjej të mblidhte paratë e nevojshme për shpenzimet e tij vetjake. Pasurinë e trashëguar nga babai i tij e ktheu në një deficit të rëndë. Mark Aurel Antoni I u vra nga një grup oficerësh.

Mark Aurel Antoni II (Elagabalus) (sundoi në vitet 218-222)

Ishte i afërm i gruas së Septimus Severus, e që më pas mori fronin pas vrasjes së Mark Aurel Antoni I. Edhe ky i fundit u dallua për mbretërimin e tij të çuditshëm. Mark Aurel Antoni ofendoi parimet morale e fetare romake. Si simbol i perëndisë së diellit ai përdori një gur të zi, gjë që për të cilën më parë do të ishte dënuar për vdekje. Romakët u ofenduan nga sjelljet seksuale të Mark Aurel Antonit. Ai njihej haptazi dhe për marrëdhëniet e tij seksuale me meshkuj. Vetëm pak historianë flasin mirë për Mark Aurel Antonin. Ai u vra nga një komplot i organizuar nga vetë gjyshja e tij.

Diokleciani (sundoi në vitet 284-305)

Mbase do duket e padrejtë ta përfshij Dioklecianin në këtë listë, pasi ai është i njohur për vendimin e rrezikshëm që mori për ta ndarë qeverinë e Perandorisë Romake në dy pjesë, duke bërë bashkë-perandor Mark Aurel Maksimianin. Diokleciani ishte një administrator i mirë, dhe arriti të mbante të bashkuar strukturën e ndarë të komandës në kohën kur perandoria romake u vu nën presion të madh nga armiqtë e jashtë kufijve. Por ajo që e bën Dioklecianin pjesë të kësaj liste, ishte persekutimi i pamëshirshëm i të krishterëve. Diokleciani kërkonte një zhdukje totale të fesë. Kishat u shkatërruan, shkrimet e u dogjën e priftërinjtë e krishterë u burgosën. Të krishterët që refuzuan të heqin dorë nga besimi i tyre u torturuan dhe u ekzekutuan. Në një kohë kur bashkimi ishte thelbësor për mbijetesën e perandorisë, frika ishte ajo që Diokleciani reflektonte.

Mark Aurel Antoni I (Karakalla) (sundoi në vitet 211-217)

Mark Aurel Antoni ishte djali i perandorit të aftë e efektiv Septimius Severus. Që të shmange skenarit e ndarjes së pushtetit me të vëllain e tij Geta,

'Amerika pa Amerikë'

(Tregim nga Roland Gjoza)



Llui i thërrisnin Luanit, pronarit të pesë Burger King-ëve në zemër të Manhattan-it. Më erdhi çudi në fillim, as që doja ta besoja, por pikërisht Llui, i pabesueshmi dhe i tejsheshturi, që s'njihej fare në komunitetin shqiptar të Nju-Jorkut, më mori në punë pasi u sorollata shtatë muaj sa andej-këtej pa ma varur njeri torbën. Kisha një muaj që piqja patate, mish, peshk, mbushja frigoriferin përplot me ushqime të ngrira e të paketuara, po Lluin ende s'ma kishin zënë sytë.

Atëherë botoja ndonjë tregim te gazeta Iliria dhe nuk e di pse më kishte hipur të shkruaja diçka për mirëbërësin tim. Një ditë isha poshtë në bimsa dhe po pastroja e sistemoja kartonët. Atje ishte qetësi, bënte fresk dhe diku poshtë elevatorit që transportonte pakot me patate lart, çarku sapo kishte zënë një mi. Ai cijaste me inat dhe pikëllim, bënte përpjekje të dilte, por qe e pamundur, kështu që herë-herë fashitej për fare, i rraskapitur nga përpjekjet e dëshpëruara pa dobi. Dikush po e këqyrte, ishte një electricist që po merrej me diçka në impiantin e pijeve freskuese. Ai qe veshur çuditërisht me një bluzë si ato tonat, bojëqielli, me inicialet e Burger King-ut. Mbante pantallona doku të zeza, të

ngjashme me ato të miat, këpucë të rëndomta, të ngrëna te shuajt. Isha mësuar të qëndroja vetëm në bimsa në atë temperaturë vjeshte, ndërsa lart ishte një i nxehtë tropiku (50 gradë celsius) që të asfiksonte. Po ky ç'do këtu, mendova, vjen pa marrë leje. Megjithatë nuk e hapa gojën, duke iu bindur edhe në këtë rrethanë tejet banale asaj që përpiquesha të më udhëhiqte në letërsi; mendohu pesë herë përpara se të hedhësh një hap. Pikërisht ai njeri aq i ndrojtur që kur iku më përshëndeti me dashamirësi, ishte Llui, shpëtimtari im. Pastaj pashë makinën e tij, një Bujk i vjetër, pothuaj i shpartalluar, që kur nisej apo frenonte për të ndaluar përballë dyqanit në Avenjunë e Pestë, 44 Street, rrapëllinte si një i çmendur. Ne qeshnim, mezi e mbanim gazin që s'na ndahej sa herë vinte ai, si një klient i ndrojtur, me po ato rroba të ronitura e të hallakatura që i vishnim edhe ne kur fillonim punë dhe sa herë largohej, na thoshte t'i bënim gati tre-katër hamburgerë, që i merrte me vete, përshëndetej me të gjithë pa fjalë, por duke na tundur kryet, dhe hiqte e vuante gjersa zinte vend në atë shkatarraqen e tij cit më cit me gjithfarë rraquesh.

Pastaj dëgjonim si rënkonte e

rrapëllinte Bujku plak duke lëshuar një re të dendur tymi poshtë rrokaqiejve të bankave të mëdha.

O Zot, ç'ishte ky njeri?

Bir i një emigranti nga Dibra. Arratisur nga Shqipëria para 40 vjetëve. Vuri pasuri: dy ndërtesa shtatëkatëshe në Manhattan dhe dy pallate të mëdha në Ozon Park, Queens.

Para se të vdiste, kishte lënë për bijtë një testament të çuditshëm: Pasurinë ta ndanin në mënyrë të barabartë.

Në punë të merrnin shqiptarë.

S'do të shisnin asnjë pronë.

Nuk do të martoheshin me të huaja.

Mallkimi i tij do t'i zinte në qoftë se nuk e shtonin pasurinë.

Të kursenin, ndryshe do të falimentonin.

Shqipërinë të mos e harronin.

Të lidheshin me fëmijët e vëllait të tij, të xhaxhait të tyre të nderuar, dhe t'i ndihmonin ata, se kur kishte ikur i kishte lënë në mjerim. Më shtoej kurioziteti për këtë njeri. Ja, ç'kishte ndodhur:

Dy djemtë e xhaxhait nga Shqipëria kishin mbërritur, më në fund, në Nju-Jork. Llui doli dhe i priti në aeroportin JFK me rrangallën e tij. Pas dyzet vjetësh ai shikonte dy burra shtatlartë, që mbaheshin me të madh, ndërsa

ata këqyrnin me një shije aspak të këndshme një punëtor të rëndomtë që iu buzëqeshte me përvuajtje. Ata ishin veshur shik dhe kur u futën në atë magazinë rraquesh, hoqën të zinjte e ullirit, por nuk e hapën gojën. Veç një e qeshur përplot mahi u mbeti në fytyrat buçkane.

Ai i solli drejt e në Burger King-un tonë. Ata porositen peshk, sallatë dhe akullore. Po nuk i prekën. Nesër ju pres në shtëpi, u tha Llui, po atje s'kam njeri, gruaja dhe fëmijët janë në Florida. Ju do të flini në krevatin e madh. Jo, nesër je i ftuar nga ne, ia kthyen ata. Dhe i lanë në dorë një kartëvizitë: Hotel Hajat, Avenju e Gjashtë.

Ata kishin zënë vend në një nga hotelet më të shtrenjta dhe dreka që hëngrën atje të nesërmen u kushtoi 2834 dollarë. Ç'do tjetër? e pyesnin të dy duke qeshur. Ç'kostum që mbante Llui! Si të paveshur ndonjëherë. Të prerë si për një tjetër. Kravata jo e modës, e hollë, i rrinte shtrembër. Sa pak që fliste! Vështronte si një delikt pjtat dhe pjtancat që vinin njëra pas tjetres dhe s'pushonin. Jo, ai s'kishte ngrënë asnjëherë gjëra të tilla, tejet grandioze e finoshe e me kaq tepri. Ndërsa dreka që iu shtroi ai në Burger King vajti aty te 26 dollarët. Ata nuk i shkuan në shtëpi, por gjithmonë e prisnin te

Hotel Hajat apo në ndonjë vend tjetër ku kishte spektakle dhe striptizë. Kishin marrë me qira një Ferrari të fundit dhe e çuan në disa qoshka të arta që ai s'i kishte parë asnjëherë.

Ishin presidentë firmash ndërtimi në Tiranë, kështu i thanë, kishin plot pallate moderne, jo si këto "vjetërsirat demode të Manhattan-it" dhe disa fabrika pijesh në autostradën Tiranë-Durrës.

U ndanë në hollin e Hotel Hajat, se ata nuk donin që ai t'i përcillte me shkatarraqen e tij në aeroportin JFK. Në fund dy vëllezërit i thanë se, po të kishte nevojë të hapte biznes në Shqipëri, do ta ndihmonin për gjithçka, veç të hapte gojën dhe këtë ia përsëritën me ton autoritar, siç mund t'ia shqiptojë një rival një tjetri, kur do t'i bëjë një sfidë prej së cilës ka vuajtur një jetë të tërë.

Ata nuk e dinin që Llui pikërisht atë ditë kishte fituar 20 milionë dollarë në kursin e aksioneve në Wall Street. Kur u larguan, më në fund, ai u ndje i lehtësuar dhe me mend bëri një zbritje të vogël në llogari, por gjithsesi të kënaqshme, karburantin e makinës nga Avenju e Gjashtë në aeroportin JFK.

Dhe i harroi krejt. /exlibris.al



Eqrem bej Vlora: Mëndësia e shqiptarit, e themeluar krejt mbi fitimet e hëpër-hëshëm

Serinë "Kuvend letrash me miqtë", nipi i Mustafa Krujës, Eugjen Merlika, e cilëson si "saga shqiptare e mërgimit". Përmes letërkëmbimit të Krujës me personazhe të njohura, krijohet historia tjetër e panjohur e mërgatës shqiptare mbas Luftës së Dytë Botërore, të cilët kundërshtuan në mënyra të ndryshme sistemin stalinist të instaluar në Shqipëri. "Të mërguarit, që arritën të shpëtojnë nga kthetrat e diktaturës, u përballuan në kohët e para me një qëndrim mosbesues të fituesve të luftës, për pasojë me kushte të vështira jetese...", shkruan Merlika në parathënien e këtij botimi, ku përfshihen letërkëmbimi të viteve 1948-50. Më poshtë janë letrat e shkruara nga Ekrem (Eqrem) bej Vlora.

Romë, 24 Qershor 1952

Indershmi mik,

Fletorja "L'Albanie Libre" Ju falënderon me zemër për bashkëpunimin t'uj të vlefshëm. Artikujt që Zotrija e Juaj i ka dërguar kësaj fletoreje kanë patur pëlqimin e gjithë lexonjësavet të saj, prandaj kjo është një arësye më tepër për të kërkuar edhe shkrime të tjera nga ana e Z. s'ujaj. Do t'u ishim mirënjohës, pra, sikur mos të na e kursenit bashkëpunimin t'Uaj të çmuar.

Jemi të sigurt se ndjeshmënis s'ujaj s'do t'i shpëtojë gjendja e mjerë e Atdheut t'onë dhe rreziku i humbjes së asaj pasurije letrare, historike e shoqërore, që vetëm me shkrimtarë si Ju mund të shpëtohet. Duke Ju falënderuar qysh tash për ndihmën që shpresojmë se do na jepni duke na dërguar, sikurse edhe më parë, bashkëpunimin t'uj të vlefshëm, Ju lutem të pranoni nderimet dhe përhëndetjet t'ona më të çquara.

*Për "L'ALBANIE LIBRE"***EKREM VLORA**

*Të ndershmit Zotni
Mustafâ Kruja Merlika
Egjypt, Aleksandri
2, rue Eglise Grecque
Schutz, Ramlech*

P.S. Ndiguam që keni botuar me anë të radjos "Free Europe" një mesazh për popullin shqiptar. Nëse është e vërtet, kemi dëshirë të njohim tekstin dhe datën që është transmetuar. Me nderime vëllaznore

Përherë i juaj

Ekrem Vlora

Romë më 9 korrik 1953

Fort i dashuri mik

Përfitoj nga rasti, qe po këthehet në Misir miku i përbashkët Z. Ago Agaj, për me ju çue këtë letër. Shpresoj e uroj, që do ju gjej me shëndet të plot e me zëmbër të gëzuar. Kanë kaluar mjaft kohë qe nuk kemi patur ndonjë çkëmbim letrash. Me gjithë këtë, besomni, nuk kalon ditë pa ju përmendur; jo vetëm për kujtimet e përbashkët që na lidhin, por edhe për çmimin e lart që u japim. Shpesh herë na keni nderuar me dërgimin e ndonjë artikullit për gazetën t'onë. Ky bashkëpunim ka qënë për neve jo vetëm një mjetë çmallje, por edhe një përfitim i vlershëm. Nga këta artikujt kuptova që merreni me studime historike. Edhe pikrisht ky fakti është, që më shtyti t'ju shkroj këtë letrën, me një përmbajtje – pak të çuditshme -.

**Më falni pra, që po ju
bezdís:**

Ju e dini, ma mirë se unë, që populli shqiptar nuk ka ende një historië të shkruar. Disa të huaj, edhe fort pak shqiptar, janë mar me përshkrimin e ndonjë kohës ose ndonjë pamjes qe i përket historisë shqiptare. Këta tregimet shëmbëlajn disa shkëmbënjeve që janë përhapur në detin e harrimit, në të cilin është fundosur historia e jonë. Mëndësia e shqiptarit, e themeluar krejt mbi fitimet e hëpër-hëshëm edhe lëndorë nuk ka lejuar veçanrisht të merret me çështje – të kota – të vdekura, që nuk paraqisnin as një

interes për të. Urija edhe nakari e kanë ndaluar mbas asaj shqiptarin, të vërë në dukje ngjarje që mund të shkaktonin çuarjen e njerzvet që ishin ende të gjall në far e fisin e vet ose në kujtimin e popullit. Më së fundi edhe injoranca ka kontribuar në mungesën e akteve qe i përkasin historisë shqiptare: i kanë grisur, i kanë humbur, se pse nuk dinin fare ti këndonin.

Kështu; kurse është shkruar diç'ka mbi historinë shqiptare, kjo ka dalë në dritë shumë shumë vjet mbas ngjarjes, nga pend e ndonjë të huaji, që nuk mund të dinte as mëndësinë e popullit t'onë, as jetën e tij, as edhe rrethanat, lidhjet me të kaluarën, që i përkasin njeriut ose njerzve që përmendeshin në këto ngjarjet.

Por të huajt, për sa i përket disa pjesave të historisë shqiptare që kanë trajtuar, kanë patur disa burime: akte, letra, shënime etj. etj. që patën shkruar disa të huaj të tjerë. Edhe ju, i dashuri mik, jeni tue studjuar historinë shqiptare, mbi këto mbeturinat. (Acta-t e Thallocy-t, Jeriçekut etj.) janë një provë për shërbimin qe kanë bërë të huajt në këtë lamë. Ata na e mblodhën një thesar, sado të mangët, e ua lanë si dhurat; por edhe si shëmbëll edhe si mbësimit se si duhet të veprojm.

Ju e dini, që pjesa më e errët e më e panjohur prej shqiptarëve në historinë e tyre i përket pikrisht kohës më të afërt = sundimit të perandorisë otomane. Mjerisht, kam ndiguar nga shumë = intelektual = shqiptar, që kjo koha në të cilën kanë vepruar = në dëm të popullit shqipo! = disa

Pashallar tyrk, nuk intereson dot = shqiptarët atdhedashës =

Më falni që përsërit të tilla = budallallëke. Por tregojn moskuptimin e esencës, e nevojës të historisë; kjo shkaktoj harrimin e saj tek neve, prandaj i përmënd.

Tash, ajo koha e turkut ka formuar – mirë a keq – at' Shqipon që krenohet sot, si populli më i çquar e më trim, e më i zoti i botës!! Neve kemi pra detyrë ta stydjojm e ta thellojm njohjen e njerzvet që kanë vepruar; jetën e popullit, rrethanat, zakonet, ngjarjet e asaj kohës. Në Shqipri'ë kemi fort pak lënd:

- 1) Kujtimet – gojëthanjet – këngat.
- 2) Gurët e varrevet.
- 3) Disa akte (në zyrtar e Vakfit, në gykatoren e Sherisë etj.)

Por mbi Shqiprinë (e kohës otomane) kemi një burim të pambaruar – në Stamboll. –

- 1) Në Hazine-i Evrak të Babi Alis.
- 2) Në shkurtimet e Fermaneve (mexhuai – Feramin 49 vlli. – 1482 – 1917).
- 3) Në babi Meshikat – Hyqam defteri –
- 4) Në ministrinë e Vakfit (Evkaf Nezareti – Kujudat defteri)
- 5) Në Ministrinë e financave (arshiv) – malije nezareti – Kujudat Shubesi – (Timar Zeamet evraki)
- 6) Ministria e luftës – Tarih

Shubesi – jenixheri defterli –

Diçka mund të gjindet edhe në Edirne; diçka që i përket kohës të sulmimevet Tyrk mbi Shqiprinë.

Më së fundi edhe gurët e varrevet (në varrezat e Ysqydarit, Ejupit dhe Jedi Kapus) mund ti shërbejn historisë shqiptare.

Këta janë pak a shumë vëndet ku mund të mblëdhim mjaft lënd që i përket historisë Shqiptare.

Në vijim të këtyre andrravet erdha në përfundim të përpiqem për të realizuar një endërr edhe më të thell. – Të gjej mjetet e nevojshme që mund ti lejojnë një grupit vogël njerzësh të shkoj në Stamboll për të mblëdhur këtë lënd e për ta botuar më një libër (me fotografit e akteve origjinale mundësisht), që ti përngaj edhe të plotsoj aktat e Thallóczy-t etj për kohën e perandorisë otomane. Nuk është as një punë e lehtë, as edhe e lirë. Por dy tre njerz, me vullnet të mirë, me diç'ka një dijeni mbi shkrimet e ndryshëm të kohës perandorisë otomane, mund të bëjnë një punë të dobijshme. Por do kohë: të paktën dy vjet. Duhet të keni parasysh që Hammeri mblodhi (edhe botoj) 5200 Fermane; ndër gjith këta – vetëm 2 – i përkasin Shqiprisë.

Çështja, për sa i përket shpenzimevet, koklavitet edhe më tepër. Për të bërë një punë të dobijshme duhen 2 veta, një sekretar, një fotograf (gjithsej 4 veta). Po llogaritëm për ç'do njeriu një rrogë mujore mesatare prej 10 napolona ari bëjnë 40/napol.ari në muaj. Për dy vjet bëjnë lart nga 1000/napol.ari: një shpenzim pra mjaft i math që mund të shkaktoj edhe shpenzime të tjera të papritura. Por botimi i një librit që përmblëdh pak a shumë gjith dokumentat që i përkasin Shqiprisë do qe një vepër themeltare për historinë t'onë. E di, nuk do bëhet dot! Me gjithë këtë mbi insistimin e Agos po ja u paraqis mendimin t'im. Nëse e gjeni të pëlqyeshëm, nëse besoni që Mbreti mund – pjesrisht – të interesohet në këtë punë, (pjesën tjetër mund që na i jep – akademia del mediterraneo – ose – Istituto orientale) paraqitjani çështjen. Tash, mjaft ju bezdisa, po i jap fund letrës t'ime tue ju lutur të pranoni çfaqjen e nderimevet më miqsore.

I juaji përherë

Ekrem Vlora
(sic.)

E jashtëzakonshme

Restorantet në Holandë me "serra të vogla" pas koronavirusit

Të shkuarit në restorant duket shumë më ndryshe, tanimë me hapjen e tyre, pas mbylljes si pasojë e koronavirusit në Holandë. Sipas mediave të huaja, restoranti Mediamatic Eten në Amsterdam ka prezantuar "serra të vogla" rreth secilës tryezë si pjesë e masave për distancimin shoqëror të koronavirusit.



FOTO E DITES



Avdullah Hoti të enjten zyrtarisht e ka marrë detyrën e kryeministrit të Republikës së Kosovës.

E rrallë

Banorët vrasin elefantin duke i dhënë ananasin me kapsollë brenda

Një elefant shtatzënë ka ngordhur pasi besohet se banorët i dhanë për të ngrënë një ananas me një kapsollë fishekzjarrësh të fshehur brenda, i cili i shpërtheu në gojë. Rasti shokues në Indi ka shkaktuar një hetim kriminal për mizori ndaj kafshëve, njoftonin zyrtarët pyjorë që kishin dëshmuar vdekjen makabre të kafshës pas



shpërthimit të kapsollës në gojë. Incidenti ndodhi në provincën e Palakkad në jug të Indisë, ku fermerët vendës shpeshherë përdorin fruta me fishekzjarrë për t'i vlarë elefantët që dëmtojnë të mbjellat e tyre.

BARSOLETA E DITËS



TELEFONATA E ÇUDITSHME
Një çifti, derisa është në kuzhinë, i bie telefoni. Përgjigjet burri:
- Alo! Po? E nga ta di unë? Telefonoji policisë rrugore.
Gruaja e pyet se kush ishte dhe burri i përgjigjet:
- As që e kam idenë... njëri pyeste nëse rruga ishte e lirë.



Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Në ora 18:00
Spies in Disguise 3D

I Animuar/Aksion/Aventurë; 1 orë 42 min

Rolet: Will Smith, Tom Holland, Ben Mendelsohn, Karen Gillan, Rashida Jones, DJ Khaled, Masi Oka

Regjia: Troy Quane, Nick Bruno



Në ora 18:00
Jumanji; The Next Level 3D

Aksion/Aventurë/Komedi; 2 orë 03 min
Rolet: Dwayne Johnson, Jack Black, Kevin Hart, Karen Gillan, Nick Jonas, Awkwafina, Ser'Darius Blain, Madison Iseman, Morgan Turner, Alex Wolff, Danny Glover, Danny DeVito, etj.
Regjia: Jake Kasdan



Çdo natë në ora 20:00
STAR WARS; THE RISE OF SKYWALKER 3D

Aksion/Aventurë/Fantazi; 2 orë 21 min
Rolet: Daisy Ridley, Adam Driver, Mark Hamill, John Boyega, Oscar Isaac, etj
Regjia: J.J. Abrams




Çdo natë në ora 22:30
THE GRUDGE


Horror/Mister; 1 orë 34 min

Rolet: Sarah Michelle Gellar, Jason Behr, Kadee Strickland, Clea Duvall and Bill Pullman


Regjia: Takashi Shimizu



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.

 <p>DASHI Ju pret një ditë pozitive për ndjenjat, ku mund të merrni diçka më shumë. Mund të keni dëshirë për diskutime dhe ndryshime. Po ashtu, duhet treguar kujdes sa i takon anës ekonomike.</p>	 <p>DEMI Në dashuri, nuk duhet të jeni shumë ngacmues. Mundohuni që të ruani qetësinë dhe të shmangni debatet. Hënën do e keni kundër dhe kjo gjë mund t'iu shkaktojë probleme në punë.</p>	 <p>BINJAKËT Bëjini gjërat qetësisht gjatë kësaj dite. Bëni mirë që të mos përfshihen në polemika dhe debate. Në punë, duhet të përqendrohni në projektet të cilat duhet t'i çoni përpara.</p>	 <p>GAFORRJA Sot do të jeni plot emocionet pozitive. Në punë, duhet të mendoni lidhur me projektet, por bëni kujdes me debatet dhe jini të matur me shpenzimet.</p>	 <p>LUANI Për të zgjidhur problemet e zemrës të lindura kohëve të fundit, duhet të duroni edhe pak. Do të keni idetë e duhura në punë dhe ka ardhur momenti që të mos qëndroni pa vepruar.</p>	 <p>VIRGJERESHA Duhet të ecni ngadalë gjatë kësaj dite, pasi mund të hani në pengesa. Jeni shumë të lodhur, ndaj duhet të rini larg problemeve. Gjatë kësaj periudhe jeni shumë të zënë me punë.</p>
 <p>PESHORJA Raportet e lindura prej pak kohësh do të ecin mirë. Çiftet që kanë kohë bashkë, do të kenë mundësi që të zgjidhni një problem. Në punë do të keni pasiguri dhe do të demoralizoheni.</p>	 <p>AKREPI Sot do të përjetoni momente shumë të veçanta në jetën në çift. Në punë ka shumë persona interesante që ju rrethojnë, ju mbetet veçse të zgjidhni të duhurin. Kini kujdes me financat.</p>	 <p>SHIGJETARI Kjo e enjte do të jetë mjaft e qetë sa i takon dashurisë. Do të keni ide të mira, për ta bërë ditën sa më interesante. Në punë dhe në sferën sentimentale, ka gjëra që do ju krijojnë probleme.</p>	 <p>BRICJAPI Nëse ka diçka që ju shqetëson, mundohuni që të mos rëndoheni. Propozimet e reja duhen vlerësuar me kujdes, duke reflektuar para marrjes së një vendimi.</p>	 <p>UJORI Mundohuni që të mos nxirrni probleme nga e kaluara. Gjatë pjesës së dytë të ditës, do të jeni të karrikuar me energji. Në punë, duhet të tregoni kujdes.</p>	 <p>PESHQIT Përballuni dhe flisni me personin me të cilin keni probleme. Do të ndjeni sikur po e çoni kohën dëm. Në punë duhet të veproni ngadalë, pasi do ju duhet të bëni disa zgjedhje.</p>

Ribashkim mes Bella Hadid dhe The Weeknd?



Mësohet se Bella Hadid dhe The Weeknd kanë nisur të flasin sërish.

Këtë e kanë konfirmuar miqtë e ngushtë të modeles për "Us Weekly" të cilët nuk e përjashtuan mundësinë që ata mund të rikthehen sërish në

krahët e njëri-tjetrit. Ish-çifti që janë njohur në vitin 2015 gjithmonë kanë pasur një marrëdhënie me luhatje dhe herën e fundit ishte Bella ajo e cila vendosi t'i jepte fund. Mesa duket ajo duhet të përqendrohej tek karriera e saj dhe udhëtimet e modelingut.

Ja si dukej Ivanka Trump përpara se të bëhej e famshme



Ivanka Trump u vendos në qendër të vëmendjes për shkak të babait të saj, president i Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Por, jo vetëm kaq. Ajo tërheq si magnet mediat rozë edhe për pamjen, edhe stilin mjaft elegant. Por ndërsa shumë persona të famshëm

i kemi parë të ndryshojnë në mënyrë drastike kur janë bërë të pasur (kirurgjia plastike sot bën mrekulli), fëmija i preferuar i Trumpit nuk ka pasur shumë nevojë për to. Ivanka, në fakt, ka qenë gjithmonë e bukur, siç e dëshmojnë edhe fotot e hershme të saj.



Rita Ora nuk kursehet, karantinimi në fshat i kushtoi 33 mijë euro

Këngëtarja me origjinë shqiptare, Rita Ora, njihet për jetën luksoze që bën e, mesa duket, edhe gjatë karantinimit nuk është kursyer aspak. Gjatë periudhës së pandemisë ajo vendosi të izolohej në një fshat në veri-perëndim të Londrës, ku kishte planifikuar që të qëndronte atje vetëm disa ditë, por më pas Londra u fut në karantinë dhe izolimi i Ritës aty u zgjat.


Vendimi i Rita Orës për të qëndruar në Cotswolds përpara se qeveria ta impononte bllokimin e mundësisë së largimit nga fshati në shtëpinë e saj në Londër, i ka kushtuar asaj jo më pak se 30 mijë funte (33 mijë euro), raporton "Daily Star Online". Por kjo është një shifër e vogël në krahasim me pasurinë e këngëtares, pasi të ardhurat e saj nga albumet dhe koncertet shkojnë në miliona euro.

Jennifer Anistoni nxjerr në shitje portretin nudo për të mbledhur para



Aktorja e famshme Jennifer Aniston do ta nxjerrë në ankand portretin nudo të realizuar në vitin 1995. Fotografia është bërë nga Mark Seliger i cili asokohe ishte punësuar për të bërë një set fotografik për të gjithë person-

azhet e "Friends". Portreti bardhë e zi ku aktorja qëndron këmbëkryq do të shitet në ankand për të mbledhur fonde rreth gjetjes së një vaksine për koronavirusin. Momentalisht oferta më e lartë për fotografinë ka arritur vlerën prej 6 500 dollarësh.



QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82

Fitorja, e vetmja alternativë për Llapin kundër Dukagjinit

IPKO Superliga, pas ndërprerjes për shkak të pandemisë, rikthehet me ndeshjen Llapi - Dukagjini, e cila zhvillohet sot në stadiumin "Zahir Pajaziti". Trajneri Tahir Batatina për "Epokën e re" ka thënë se e vetmja alternativë për klubin e tij në këtë ndeshje është fitorja, derisa sulmuesi Granit Arifaj beson se mund të befaset skuadra e Llapit



ka të drejtë loje për shkak të kartonëve", ka thënë Batatina. Për dallim nga Llapi, Dukagjini do të luajë në këtë ndeshje pa presion të madh për faktin se tashmë ka pak gjasë për ta siguruar ekzistencën në Superligë. Megjithatë, Granit Arifaj për gazetë ka thënë se në Podujevë udhëtojnë për

rezultat pozitiv. "Ka qenë një kohë e shkurtër për t'u përgatitur mirë, por jemi munduar ta shfrytëzojmë kohën që kemi pasur. Në ndeshjen ndaj Llapit shkojmë për ta dhënë maksimumin dhe nëse na jepet rasti, synojmë edhe të fitojmë. Për këtë ndeshje na mungon Abu

Kamara që s'ka të drejtë loje dhe të lënduarit Ilir Mustafa dhe Granit Elezaj", ka thënë Arifaj. Kjo ndeshje zhvillohet me fillim nga ora 16:00, kurse të shtunën zhvillohen dy ndeshjet e tjera për këtë xhiro dhe java mbyllet me tri ndeshjet që janë në program të zhvillohen të dielën.

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 4 QERSHOR - Pas dy ndeshjeve të para gjysmëfinale të Digitalb Kupës së Kosovës në futboll rikthehet edhe IPKO Superliga. Ndeshja e parë e javës së 23-të zhvillohet në stadiumin "Zahir Pajaziti" në mes të Llapit dhe Dukagjinit nga Klina. Llapi aktualisht është në pozitën e gjashtë me 34 pikë, por trajneri Tahir Batatina ka thënë të enjten për "Epokën e re" se synim i kësaj skuadre është fitorja në këtë ndeshje dhe synimi që në fund të përfundojë në mesin e skuadrave më të mira në elitë dhe ta sigurojë pjesëmarrjen në garat evropiane. "Për kohën që kemi pasur në dispozicion

jemi përgatitur maksimalisht dhe në ndeshjen ndaj Dukagjinit synojmë tri pikë. Llapi do të mundohet ta përfundojë kampionatin në njërin nga pozitën e para dhe të dalë në Evropë. Mungesa e vetme për ndeshjen e radhës është Behar Maliqi, i cili nuk

IPKO SUPERLIGA

Të premten takohen:
16:00 Llapi - Dukagjini

Të shtunën takohen:
16:00 Feronikeli - Vushtrria
16:00 Drita - Flamurtari

Të dielën takohen:
16:00 Gjilani - Flamurtari
16:00 Ballkani - Drenica
18:00 Prishtina - Ferizaj

KF Drenica: Nuk është sulmuar trajneri Gani Sejdiu



SKENDERAJ, 4 QERSHOR (ER) - KF Drenica ka reaguar në një njoftim për medie lidhur me rastin e sulmit ndaj trajnerit Gani Sejdiu. Klubi kuqez i nga Skenderaj ka mohuar të ketë ndodhur një gjë e tillë, por bën me dije se ka pasur vetëm diskutime normale dhe të arsyeshme të kryesisë së klubit dhe kryesisë së tifozëve 'Shqiponjat e Zeza'. "Nuk janë të vërteta pretendimet e disa

medieve, që është sulmuar trajneri i KF Drenica, Gani Sejdiu, të martën mbrëma. KF Drenica, për hir të korrektësisë dhe informimit sa më të drejtë të opinionit, njofton se tifozët e klubit, 'Shqiponjat e Zeza', kanë qenë të revoltuar nga humbja e ekipit nga FC Prishtina dhe normalisht kanë pasur pakënaqësi, pasi që të gjithë do të donin që Drenica të kishte paraqitje më të mirë

dhe t'i afrohej finales së Digitalb Kupës së Kosovës në futboll, por e theksojmë se nuk ka pasur asnjë sulm ndaj askujt e as trajnerit të KF Drenica. Ka pasur diskutime normale dhe të arsyeshme të kryesisë së KF Drenica dhe kryesisë së tifozëve 'Shqiponjat e Zeza', por asnjë lloj sulmi nuk ka pasur ndaj askujt", thuhet në njoftimin e Drenicës.

Ekipi i xhudos sot zhvendoset në Shqipëri

PEJË, 4 QERSHOR - Ekipi i xhudos, pas dymbëdhjetë javë vetëizolimi, do të shkojë sot (e premte) në Shqipëri. Trajneri Driton Kuka ka thënë se ekipi i xhudos do të ketë një javë pa ngarkesa të stërvitjeve. "Prej nesër ekipi i vetëizoluar do të

vazhdojë të qëndrojë në shtetin amë, Shqipërinë, këta djem e vajza do t'i shijojnë bukuritë me vizita në shumë vende. Do të kemi një javë pa ngarkesa të stërvitjeve, një javë në kërkim të qetësisë pas një situatë të pazakonshme. Një

javë që të do punojmë për mbushjen e baterive nëpërmes pushimit aktiv me përkujdesje për shëndetin mental të këtyre kolosëve të kombit. Jam krenar për qëndrueshmëri dhe vullnet për stërvitje edhe atëherë kur bota

ishite ndalur. Xhudistët nuk u ndalën për asnjë moment. Do të vijmë sukseset, jam i bindur, siç isha i bindur se do të arrini aty ku jeni sot, me medalje të arta evropiane, botërore deri tek e arta olimpike", ka thënë Kuka.



Rexha: Drita e fiton titullin

GJILAN, 4 QERSHOR - Sulmuesi i FC Drita, Kastriot Rexha, është i bindur se skuadra e tij mund ta fitojë titullin e kampionit në Kosovë. Në fundjavë do të rinisin

ndeshjet e Superligës të cilat janë ndërprerë rreth tre muaj më parë për shkak të koronavirusit. "Po, përgatitjet janë duke shkuar shumë mirë. Jemi në ditët e fundit

para ndeshjeve dhe kemi besim te skuadra", ka thënë Rexha për "Gazeta-Topi". "Mendoj se Drita ka skuadër të mirë. Ka lojtarë me përvojë që në fund edhe mund ta

fitojnë titullin e kampionit", ka deklaruar Rexha. Drita aktualisht është e dyta me 43 pikë, vetëm një më pak se lideri i tabelës, Ballkani.



Kosova dhe Shqipëria përgatiten për ligën e përbashkët

PRISHTINË, 4 QERSHOR - Federata e Basketbollit e Kosovës (FBK) dhe Federata Shqiptare e Basketbollit (FShB) janë në vllugun e përgatitjeve për krijimin e Ligës së Përbashkët, që pritet të fillojë në shtator të këtij viti. Ekipet teknike të FBK-së dhe FShB-së, të udhëhequra nga sekretarët e përgjithshëm, sot i kanë përfunduar përgatitjet e draft-dokumenteve të nevojshme për krijimin dhe jetësimin e Ligës së Përbashkët Kosovë - Shqipëri. "Për dy javë aq sa kemi pasur kohë ne si ekipe teknike i kemi përgatitur të gjitha dokumentet natyrisht në formë të drafteve, pasi që ato fillimisht duhet ta marrin dritën e gjelbër nga kryetarët e të dyja federatave dhe nga bordet ekzekutive të të dyja federatave. Gjatë hartimit të këtyre dokumenteve në formë të drafteve ne kemi pasur

bashkëpunim shumë të mirë me ekipin teknik të FShB-së të udhëhequr nga sekretari i përgjithshëm, Korab Llazani dhe mund të them se jetësimi i kësaj lige sikur na ka motivuar shumë, por edhe na ka emocionuar, duke marrë parasysh faktin se për këtë ligë është përfolur shumë në vitet e fundit", ka thënë Elvira Dushku, sekretare e përgjithshme e FBK-së. Sipas Dushkut, liga e përbashkët Kosovë - Shqipëri ka zgjuar interesim të madh jo vetëm në Kosovë e Shqipëri, por edhe më gjerë. "Pas përfundimit të procedurave të votimit të dokumenteve nga bordet ekzekutive të të dyja federatave ne do të jemi të gatshëm të vazhdojmë me nënshkrimin e marrëveshjes e cila do t'i jepte vulën përfundimtare krijimit të ligës. Ndërkaq në mbledhjen e radhës së Bordit të FBK-së pritet

të diskutohet dhe të vendoset për ekipet nga Kosova që pritet të marrin pjesë në këtë ligë, derisa të njëjtën gjë pritet ta bëjë edhe Shqipëria. Liga e përbashkët Kosovë - Shqipëri ka zgjuar interesim të madh jo vetëm në Kosovë e Shqipëri, por edhe më gjerë, pasi tashmë kanë filluar edhe disa shtete të tjera të Ballkanit të interesohen për krijimin e ligave të përbashkëta ndërmjet dy apo tri shteteve dhe kjo sigurisht shkon në favor të basketbollit dhe marketingut të sportit tonë të zemrës". Duhet theksuar se në ekipin teknik të FBK-së për përgatitjen e dokumenteve për Ligën e Përbashkët kanë punuar Elvira Dushku, sekretarësh e përgjithshme, Faton Kurshumlja, FIBA Instruktur Nacional dhe Leart Hoxha, anëtar i Bordit të FBK-së.



Maqedonia anulon sezonin futbollistik

SHKUP, 4 QERSHOR - Pas një seance të jashtëzakonshme të Bordit të Drejtorëve të Federatës së Futbollit të Maqedonisë, duke u marrë parasysh situata e përgjithshme epidemiologjike dhe faktin se numri i të infektuarve me Covid-19 po rritet, ka marrë vendim për anulimin e sezonit futbollistik, përfshirë edhe garat në Kupën e Maqedonisë. Në Maqedoni së

fundi janë konfirmuar shumë raste të të infektuarve me Covid-19, përfshirë edhe lojtarë të Shkëndijës dhe Renovas, e lojtarët e këtyre të fundit janë dërguar në vetizolim për dy javë. Një situatë e tillë e jashtëzakonshme, duke pasur parasysh se edhe masat e kufizimit të lëvizjes janë rikthyer në këtë, e kanë bërë të

pamundur vazhdimin e kampionatit të futbollit. Federata e Futbollit të Maqedonisë, po ashtu, ka vendosur që sezonin 2019/2020 ta shpallë të pavlefshëm, duke mos i dhënë askujt titullin e kampionit. Ky vendim do të prekë drejtpërdrejt Vardarin, që po kryesonte në tabelë dhe ishte rrugës së mirë për t'u shpallur kampion.

SHKURT

Ish-përzgjedhësi Bunjaki takon drejtuesit e F. C 'Hajvalia 2020'

Ish-përzgjedhësi i Kosovës në futboll, Albert Bunjaki, ka takuar kryetarin e F. C "Hajvalia 2020", Bashkim Rama dhe disa prej themeluesve të këtij klubi. Bunjaki e ka përgëzuar kryetarin Rama për themelimin e klubit dhe ka premtuar se do të jetë një mik i mirë i F. C "Hajvalia 2020". "Bunjaki ka përgëzuar kryetarin Rama për themelimin e klubit dhe ka garantuar se do të jetë një mik i mirë i F. C 'Hajvalia 2020'. Familja jonë sportive i uron suksese të mëtutjeshme trajnerit Albert Bunjaki dhe shpreson ta shohë në majat e futbollit evropian", thuhet në njoftimin e F. C "Hajvalia 2020".

Messi lëndohet në stërvitje

Lajme aspak të mira te Barcelona teksa rrezikojnë që të mos ta kenë Lionel Messin të gatshëm për rifillimin e kampionatit. Futbollisti argjentinas është ndalur nga një dëmtim në stërvitje, duke bërë që ditën e djeshme të kryente seancë vetëm në palestër. Sipas "TV3", futbollisti ka ndier dhimbje në këmbën e djathtë, ku bëhet fjalë për një problem të vogël në aduktor. Sulmuesi do të kryejë analiza më të hollësishme për ta kuptuar shkallën e dëmtimit. Mediat spanjolle shkruajnë se argjentinas nuk do të jetë gati për ndeshjen e parë pas rifillimit të kampionatit kundër Mallorcas, më 13 qershor, pasi dëmtime të tilla zakonisht 7 deri në 10 ditë kohë për t'u rikuperuar.

McGregori gati ta sfidojë legjendën e UFC-së

Conor McGregor është gati të përballet me një nga legjendat e arteve marcialle mikse, Anderson Silva. Dy sportistët kanë një miqësi të mirë mes tyre aq sa irlandezi e ka cilësuar Silvan si më të mirin në historinë e arteve marcialle mikse. Ky i fundit i ka bërë një ftesë McGregor për të dueluar mes tyre në peshën e mesme, peshë ku Silva ka bërë historinë si kampion i padiskutueshëm. Në këtë divizion ai u bë kampion bote në vitin 2006 dhe e mbajti titullin deri në vitin 2013. Pas deklaratës së Silva për të dueluar ndaj McGregor ka ardhur përgjigja e thjeshtë e irlandezit: "Pranoj!" Një duel që duket disi i vështirë për t'u realizuar, duke qenë se Silva nuk duelon prej një viti dhe është 45 vjeç. Gjithsesi, për fansat e UFC-së kjo do të ishte një përballje e bukur mes dy prej ikonave të arteve marcialle mikse.

Unitedi ofron 80 milionë për Koulibaly

Manchester Unitedi verën e kaluar e transferoi Harry Maguire për 90 milionë euro, por synim i kësaj skuadre është transferimi edhe i një mbrojtësi cilësor. Fjala është për anëtarin e Napolit, Kalidou Koulibaly, për të cilin klubi anglez është gati të ofrojë 80 milionë euro. Klubi italian kërkon 80 milionë euro për mbrojtësin e qendrës, por marrëveshja mund të arrihet sidomos pas krizës që ka sjellë pandemia e koronavirusit.

Nuk dënohen futbollistët që protestuan në fushën për vdekjen e Floydit

Nuk ka asnjë penalizim për katër futbollistët e Bundesligës që në ndeshjet e fundjavës protestuan sipas mënyrës së tyre për vdekjen e George Floydit afro-amerikanit që humbi jetën gjatë arrestimit në Minneapolis. Thuram, Sancho, Hakimi dhe McKenzie u përfshinë në një hetim disiplinor nga Federata Gjermane e Futbollit, që po vetë "shpëtoi" lojtarët nga penalizimet. "Bëhet fjalë për një fushatë të përqendruar kundër racizmit. Ky është një impenjim dhe vlerë e Bundesligës", ka bërë me dije presidenti i Komitetit të Kontrollit në Federatën Gjermane. Më parë katër futbollistët u morën në mbrojtje nga vetë FIFA, që vlerësoi gjestin e tyre.



PËRSHKRIMI I NDËRMARRJES

Kompania Rajonale Ujësjellësi "Prishtina" sh.a., është Ndermarrje Publike e cila në kuadër të veprimtarisë së saj inkorporon grumbullimin, përpunimin dhe ofrimin e shërbimit të ujit për pije dhe largimin e ujërave të zeza, ku zona e shërbimit të veprimtarisë shtrihet në teritorin e 8 (tetë) komunave brenda regionit të Prishtinës. KRU "Prishtina" sh.a., ka 564 punëtor aktual të profilit të ndryshme që mundësojnë realizimin e përbushjes së kërkesave për ofrimin e shërbimit të ujit të pijes.

Konform me funksionet dhe kompetencat që parashihen në Nenin 21, lidhur me Nenin 17 të Ligjit për Ndermarrjet Publike Ligji Nr.03/L-087, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.04/L-111 për NP, dhe Kodit të Etikës dhe Qeverisjes Korporative për Ndermarrjet Publike, Bordi i Përkohshëm i Drejtorëve të KRU "Prishtina" Sh.A., shpall këtë:

**KONKURS PUBLIK
Për plotësimin e pozitave:**

1. Kryeshef Ekzekutiv i Kompanisë Rajonale të Ujësjellësit "Prishtina" Sh.A.
2. Zyrtar Kryesor Financiar i Kompanisë Rajonale të Ujësjellësit "Prishtina" Sh.A.
3. Zyrtar për Auditim të Brendshëm i Kompanisë Rajonale të Ujësjellësit "Prishtina" Sh.A.
4. Sekretar i Kompanisë Rajonale të Ujësjellësit "Prishtina" Sh.A.

1. Titulli i punës: KRYESHEF EKZEKUTIV

Vendi: Prishtinë
Ndermarrja: Kompania Rajonale e Ujësjellësit "Prishtina" Sh.A.
I përgjigjet: Bordit të Drejtorëve

Kushtet dhe kualifikimet e kërkuara:

Bordi i Drejtorëve dëshiron të sigurohet që të gjithë kandidatët potencial të jenë persona me integritet të njohur të cilët i plotësojnë kushtet e kualifikimit sipas nenit 17.1, si dhe plotësojnë kriteret e pavarësisë sipas nenit 17.2 pikat (d), (f), (k) dhe (l) të Ligjit për Ndermarrjet Publike dhe kanë përvojën e nevojshme profesionale dhe shkollimin e kërkuar për pozitën në fjalë të cilat kërkojnë që kandidatët duhet të plotësojnë këto kriteret:

- Kandidati duhet të ketë diplomë universitare në lëminë e administrimit të biznesit, ekonomisë, financave, inxhinierisë, juridik apo nga fushë-veprimtarisë e Ndermarrjes (së paku 4 vite studimi pas shkollës së mesme). Diplomën nga universitetet jashtë vendit duhet të jenë të nostrifikuara.
- Kandidati duhet të ketë së paku 5 vite përvojë në nivel të lartë të menaxhimit, preferohen individët me përvojë në ndermarrjet korporata tjera me madhësi dhe kompleksitet të lartë duke përfshirë edhe kërkesat tjera që i parashihet në 17, pikat 3 e Ligjit Nr.03/L-087 i ndryshuar dhe plotësuar më vonë.
- Të ketë integritet të lartë moral e profesional.
- Aftësi për udhëheqje për arritjen e objektivave të përgjithshme;
- Të ketë aftësi të dëshmuara në menaxhim.
- Njohja e gjuhëve të huaja është përparësi.

Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore të Kryeshefit Ekzekutiv:

- Të menaxhojë kompaninë në baza ditore në pajtim me aktet ligjore dhe politikën e kompanisë,
- Të zbatojë qëllimet strategjike dhe objektivat e kompanisë duke i dhënë drejtim lidhësi drejt arritjes së misionit dhe vizionit të kompanisë,
- Mbështet punën e Bordit të Drejtorëve me anë të propozimeve lidhur me politikën dhe vendimet që do t'i marr Bordi;
- Është përgjegjës për shërbimet që ofron kompania duke mbikëqyrë kualitetin e programit të përgatitjes së shërbimeve, marketingun dhe shitjen e këtyre shërbimeve;
- Propozon buxhetin vjetor për aprovim të Bordit të Drejtorëve, si dhe me kompetencë menaxhon resurset financiare të kompanisë brenda ligjeve dhe rregullores të aplikueshme;
- Në mënyrë efektive menaxhon resurset njerëzore të kompanisë brenda politikave zyrtare të kompanisë dhe procedurave konform ligjeve në fuqi;
- Siguron që misioni dhe programi i Kompanisë dhe i shërbimeve të saj, të jenë në mënyrë të vazhdueshme dhe fuqishëm të prezantuar për të krijuar një pasqyrim pozitiv të kompanisë të palët e interesit;
- Mbikëqyrë ngritjen e fondeve, planifikimin dhe zbatimin e tyre, duke përfshirë identifikimin e burimeve të financimit, si dhe përgatitjen e strategjisë për të ju qasur këtyre burimeve dhe ofruar propozim për administrimin dhe dokumentimin e ngritjes së këtyre fondeve;
- Menaxhon politika dhe zbaton vendimet e Bordit në pajtim me legjislacionin në fuqi;
- Kujdeset për operacionet ditore të Ndermarrjes dhe angazhohet që ato të jenë në të mirë të Ndermarrjes;
- Bënë vlerësimin e kontrollit të brendshëm dhe ndermerr masat e nevojshme që ai të jetë funksional për të menaxhuar dhe mbajtur nën kontroll rreziqet që i kanosen veprimtarisë së Ndermarrjes;
- Përfaqëson ndermarrjen më palët tjera sipas detyres zyrtare dhe aty ku ka nevojë edhe me autorizimet e Bordit të Drejtorëve.

2. Titulli i punës: ZYRTAR KRYESOR FINANCIAR

Vendi: Prishtinë
Ndermarrja: Kompania Rajonale e Ujësjellësit "Prishtina" Sh.A.
I përgjigjet: Kryeshefit Ekzekutiv dhe Bordit të Drejtorëve

Kushtet dhe kualifikimet e kërkuara:

Bordi i Drejtorëve dëshiron të sigurohet që të gjithë kandidatët potencial të jenë persona me integritet të njohur të cilët i plotësojnë kushtet e kualifikimit sipas nenit 17.1, si dhe plotësojnë kriteret e pavarësisë sipas nenit 17.2 pikat (d), (f), (k) dhe (l) të Ligjit për Ndermarrjet Publike dhe kanë përvojën e nevojshme profesionale dhe shkollimin e kërkuar për pozitën në fjalë të cilat kërkojnë që kandidatët të plotësojnë këto kriteret:

- Të ketë diplomë universitare dhe përvojë të konsiderueshme profesionale nga fusha e financave dhe/ose kontabilitetit;
- Të ketë së paku 5 vite përvojë pune në menaxhim të dëshmuar në financa dhe/ose kontabilitetit;
- Të ketë integritet të lartë moral e profesional;
- Të ketë aftësi të dëshmuara në menaxhim;
- Të ketë njohuri në interpretimin e Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (SNK) dhe të Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) në bazë të cilave raporton Ndermarrja;
- Të jetë kontabilist i çertifikuar sipas një programi në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Edukimit (SNE) dhe sipas udhëzimeve të Federatës ndërkombëtare të Kontabilistëve (FNK) do të jetë përparësi;
- Njohja e gjuhëve të huaja është përparësi;
- Aftësi të forta bindëse nder-personale;
- Aftësi për udhëheqje për arritjen e objektivave të përgjithshme;
- Preferohet individë me përvojë pune në ndermarrjet korporata tjera me madhësi dhe kompleksitet të lartë.

Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore:

- Zyrtari Kryesor Financiar (ZKF) do të menaxhojë çështjet financiare të Kompanisë nën drejtimin dhe mbikëqyrjen e KE-së dhe Komitetit të Auditimit në përputhje me legjislacionin primar dhe sekondar për menaxhimin e Ndermarrjeve Publike;
- Mirëmbajtjen e llogarisë së Kompanisë të azhurnuar dhe të saktë;
- Themelimin dhe udhëheqjen e të gjitha kontrollëve të brendshme financiare, duke përfshirë blerjet, pranimet e parave të gatshme dhe pasuritë themelore;
- Monitoron llogaritë e pagueshme dhe kordinon pagesën e faturave dhe blerjet speciale;
- Rishikon shpenzimet e të punësuarve për të siguruar pajtueshmeri me politikën e Kompanisë dhe buxhetin para pagesës së tyre;
- Përgatitë të dhënat e Kompanisë për auditim në fund të vitit;
- Koordinon funksionet tjera të biznesit, siç janë dhënjat me qira e objekteve dhe paisjeve, si dhe të bëjë blerje me KE dhe zyren apo funksionin e prokurimit të Kompanisë;
- Menaxhon thesarin e kompanisë, vendos dhe përgatitë buxhetin dhe çfarëdo detyre tjetër financiare të përcaktuar nga KE apo BD;
- Përgatitë dhe raportin për gjëndjen financiare të kompanisë në përputhje me standardet ndërkombëtare të raportimit financiar në përputhje me legjislacionin në fuqi;
- Bashkëpunon me auditorin e jashtëm për çështje të auditimit dhe bënë përpjekje maksimale për implementimin e rekomandimeve të cilat vijnë si rrjedhojë e një auditimi të brendshëm, të jashtëm ose nga çfarëdo organi tjetër këshillues apo ofrues i sigurisë;
- Bashkëpunon me zyrtaret tjerë të Ndermarrjes siç janë: Kryeshefi Ekzekutiv, Auditori i Brendshëm dhe Sekretari i Korporatës për të ndihmuar në ndermarrjen në arritjen e objektivave të Organizatës.

Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore:

- Zyrtari Kryesor Financiar (ZKF) do të menaxhojë çështjet financiare të Kompanisë nën drejtimin dhe mbikëqyrjen e KE-së dhe Komitetit të Auditimit në përputhje me legjislacionin primar dhe sekondar për menaxhimin e Ndermarrjeve Publike;
- Mirëmbajtjen e llogarisë së Kompanisë të azhurnuar dhe të saktë;
- Themelimin dhe udhëheqjen e të gjitha kontrollëve të brendshme financiare, duke përfshirë blerjet, pranimet e parave të gatshme dhe pasuritë themelore;
- Monitoron llogaritë e pagueshme dhe kordinon pagesën e faturave dhe blerjet speciale;
- Rishikon shpenzimet e të punësuarve për të siguruar pajtueshmeri me politikën e Kompanisë dhe buxhetin para pagesës së tyre;
- Përgatitë të dhënat e Kompanisë për auditim në fund të vitit;
- Koordinon funksionet tjera të biznesit, siç janë dhënjat me qira e objekteve dhe paisjeve, si dhe të bëjë blerje me KE dhe zyren apo funksionin e prokurimit të Kompanisë;
- Menaxhon thesarin e kompanisë, vendos dhe përgatitë buxhetin dhe çfarëdo detyre tjetër financiare të përcaktuar nga KE apo BD;
- Përgatitë dhe raportin për gjëndjen financiare të kompanisë në përputhje me standardet ndërkombëtare të raportimit financiar në përputhje me legjislacionin në fuqi;
- Bashkëpunon me auditorin e jashtëm për çështje të auditimit dhe bënë përpjekje maksimale për implementimin e rekomandimeve të cilat vijnë si rrjedhojë e një auditimi të brendshëm, të jashtëm ose nga çfarëdo organi tjetër këshillues apo ofrues i sigurisë;
- Bashkëpunon me zyrtaret tjerë të Ndermarrjes siç janë: Kryeshefi Ekzekutiv, Auditori i Brendshëm dhe Sekretari i Korporatës për të ndihmuar në ndermarrjen në arritjen e objektivave të Organizatës.

3. Titulli i punës: ZYRTAR PËR AUDITIM TË BRENDSHËM

Vendi: Prishtinë
Ndermarrja: Kompania Rajonale e Ujësjellësit "Prishtina" Sh.A.
I përgjigjet: Bordit të Drejtorëve/Komitetit të Auditimit

Kushtet dhe kualifikimet e kërkuara:

Bordi i Drejtorëve dëshiron të sigurohet që të gjithë kandidatët potencial të jenë persona me integritet të njohur të cilët i plotësojnë kushtet e kualifikimit sipas nenit 17.1, si dhe plotësojnë kriteret e pavarësisë sipas nenit 17.2 pikat (d), (f), (k) dhe (l) të Ligjit për Ndermarrjet Publike dhe kanë përvojën e nevojshme profesionale dhe shkollimin e kërkuar për pozitën në fjalë të cilat kërkojnë që kandidatët duhet të plotësojnë këto kriteret:

- Kandidati duhet të ketë diplomë universitare në fushën ekonomike.
- Të jetë Kontabilist i Certifikuar.
- Të jetë Auditor i Brendshëm i Certifikuar.
- Kandidati duhet të ketë së paku 5 vite përvojë në fushën e auditimit/financave ose kontabilitet, e preferueshme në auditim të brendshëm.
- Të ketë integritet të lartë moral e profesional.
- Aftësi për udhëheqje për arritjen e objektivave të përgjithshme.
- Të ketë aftësi të dëshmuara në menaxhim.
- Të ketë njohuri mbi Standardet ndërkombëtare dhe praktikave profesionale të auditimit të brendshëm.
- Njohja e standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit dhe të raportimit financiar është përparësi.
- Njohja e gjuhëve të huaja është përparësi.

Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore të Zyrtarit Kryesor të Auditimit:

- Drejtim efektiv të aktivitetëve audituese më qëllim të shtimit të vlerës së operimeve dhe përmirësimit të tyre në vazhdimësi;
- Planifikimi dhe kryerja e auditimit për të shtuar vlerën e organizatës sikur në aspektin operativ, financiar dhe atë të përputhshmërisë me legjislacionin në fuqi të cilin operon ndermarrja;
- Planifikimi i auditimeve strategjike, vjetore dhe ato të angazhimit në mbështetje të një qasje të bazuar në risk;
- Zhvillimi i programeve të auditimit dhe pyetësorve adekuat për verifikim të funksionimit të kontrolleve të brendshme për angazhim të ri, rishikim dhe përmirësim të programeve dhe pyetësorve ekzistues;
- Mbikëqyrja e punës së zyrës dhe angazhimeve individuale të secilit auditor në njësi;
- Sigurimi i kualitetit të punës së auditorëve në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe praktikave profesionale për auditim të brendshëm;
- Përgatitje e draft-raportit të auditimit duke identifikuar përparësitë dhe dobësitë, përfshirë dhenien e rekomandimeve dhe konkluzioneve;
- Drejtim dhe kryerja e kontrollit të rastit dhe hetimeve të ndryshme në bazë të kërkesës së menaxhimit të lartë të KRU "Prishtina" sh.a., si dhe Komitetit të Auditimit;
- Hartimi i raporteve lidhur me auditimet e kryera;
- Kryerja e punëve të tjera nga auditimi intern sipas nevojës (detyra të këshillimit për menaxhmentin) sipas kërkesës së menaxhmentit;
- Përbush çfarëdo detyre tjetër të përcaktuar nga ana e Komitetit të Auditimit.

4. Titulli i punës: SEKRETAR

Vendi: Prishtinë
Ndermarrja: Kompania Rajonale e Ujësjellësit "Prishtina" Sh.A.
I përgjigjet: Bordit të Drejtorëve dhe Kryeshefit Ekzekutiv

Kushtet dhe kualifikimet e kërkuara:

Bordi i Drejtorëve dëshiron të sigurohet që të gjithë kandidatët potencial të jenë persona me integritet të njohur të cilët i plotësojnë kushtet e kualifikimit sipas nenit 17.1, si dhe plotësojnë kriteret e pavarësisë sipas nenit 17.2 pikat (d), (f), (k) dhe (l) të Ligjit për Ndermarrjet Publike dhe kanë përvojën e nevojshme profesionale dhe shkollimin e kërkuar për pozitën në fjalë të cilat kërkojnë që kandidatët të plotësojnë këto kriteret:

- Të ketë diplomë universitare në ligj.
- Të ketë së paku 5 vite përvojë pune juridike profesionale nga fusha e qeverisjes korporative siç kërkohet me ligjin për ndermarrjet publike.
- Përparësi të ketë të kryer Provimin e Jurisprudencës.
- Të ketë integritet të lartë moral e profesional.
- Të ketë aftësi të dëshmuara në menaxhim.
- Njohja e gjuhëve të huaja është përparësi.
- Aftësi të forta bindëse nder-personale.

Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore:

- Të sigurohet që përcillen procedurat e Bordit, ku bëjnë pjesë organizimi i takimeve të Bordit, Komiteteve të Bordit dhe aksionarëve duke përfshirë (në bashkëpunim me Kryesuesin) përgatitjen dhe shpërndarjen e agjendave tek Bordi dhe NJPMNP së paku tri ditë para mbledhjes së rregullt të Bordit apo një ditë para mbledhjes së jashtëzakonshme të Bordit.
- Të mbajë procesverbalin e takimeve dhe të shpërndajë ato procesverbale tek drejtorët dhe NJPMNP më se largu shtatë ditë nga mbajtja e mbledhjes së Bordit;
- Të merret me regjistrimin zyrtar të ndryshimeve të cilat kërkohen sipas ligjit të regjistruhen në regjistrin e Kosovës për shoqëritë tregtare dhe emrat tregtar;
- Të mirret me çështjet e tjera të qeverisjes korporative sipas nevojës.
- Të raportojë në baza mujore, tremujore e vjetore për punën e vet tek Bordi i Drejtorëve dhe i njëjti raport shkon edhe tek KE si pjesë e përberse e raportit të mbledhjes të NP.
- Sipas udhëzimeve nga Kryesuesi, përgjegjësitë e Sekretarit të Korporatës përfshijnë sigurimin e rrjedhjes së mirë të informatave brenda Bordit dhe komiteteve të tij dhe në mes të Bordit dhe menaxherëve të lartë të Ndermarrjes.
- Këshillat dhe shërbimet e Sekretarit të Korporatës duhet të jenë në dispozicion të të gjithë drejtorëve i cili ndërherit është përgjegjës tek Bordi për të siguruar që përputhen procedurat e Bordit.
- Të veproj si Këshilltar tek KE për çështjet e përgjithshme ligjore dhe administrative të Ndermarrjes.

Procedura për aplikim:

Aplikacioni-kërkesa mund të merret në web-faqen e Kompanisë dhe i bashkangjiten: një C.V. e detajuar, letra motivuese, dëshmitë e përgatitjes profesionale, dëshmitë e eksperiencës në punë, certifikata nga gjykata kompetente që nuk është nën hetime, jo më e vjetër se 6 (gjashtë) muaj ose të mos jetë i dënuar dhe dorëzohen personalisht në adresën: KRU "Prishtina" sh.a., Rr."Hazir Shala" nr.4, në zyren nr.36. Deklarata nën Betim nënshkruhet në momentin e dorëzimit të aplikacionit. Afati i fundit për aplikim: 03 Korrik 2020 (e Premte), ora 16:00 h.

Yëreite: Kandidatët me dokumentacion të pa-kompletuar, të pa-plotësuar dhe joadekuat do të refuzohen. Do të kontaktohen vetëm kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret e përcaktuara dhe përfshihen në listën e ngushtë.





DESCRIPTION OF ENTERPRISE

The Regional Water Company "Prishtina" j.s.c., is a Public Enterprise which provides services of collection, treatment and provision of drinking water and disposal of waste water, the service area covering 8 (eight) municipalities within the Prishtina region. Currently RWC "Prishtina" j.s.c. has 564 employees of various profiles who enable realization and meeting demands for provision of drinking water service.

In accordance with the functions and competencies provided in Article 21, referring Article 17 of the Law on Public Enterprises Law No. 03 / L-087, as amended and supplemented with Law No. 04 / L-111 on NP, and the Code of Ethics, and Corporate Governance for Public Enterprises, the Temporary Board of Directors of RWC "Prishtina" J.S.C., announces the following:

PUBLIC VACANCY To fill in the positions:

1. Chief Executive of the Regional Water Company "Prishtina" J.S.C.
2. Chief Financial Officer of the Regional Water Company "Prishtina" J.S.C.
3. Internal Audit Official of the Regional Water Company "Prishtina" J.S.C.
4. Secretary of the Regional Water Company "Prishtina" J.S.C.

1. Job Title: CHIEF EXECUTIVE

Place: Prishtina
Enterprise: Regional Water Company "Prishtina" J.S.C.
Reports: The Board of Directors

Required conditions and qualifications:

The Board of Directors wants to ensure that all potential candidates are persons with known integrity who meet the qualification requirements under Article 17.1, as well as meet the independence criteria under Article 17.2 points (d), (f), (k) and (l) of the Law on Publicly Owned Enterprises, and have the necessary professional experience and the required education for the position in question, which requires the following criteria:

- The candidate must have a university degree in the field of business administration, economics, finance, engineering, law or in the field of activity of the Enterprise (at least 4 years of study after high school). Diplomas from universities abroad must be nostrified.
- The candidate must have at least 5 years of experience in the high level of management, experienced individuals in other corporations with high sizes and complexity are preferred, including other requirements provided by Article 17, point 3 of Law No. 03 / L-087 amended and supplemented later.
- High moral and professional integrity.
- Leadership skills to achieve general objectives;
- Proven management skills.
- Knowledge of foreign languages is an advantage.

Main tasks and responsibilities of the Chief Executive:

- Manages the Company in daily basis in accordance with legal acts and policies of the Company,
- Executes strategic purposes and objectives of the company by directing the leadership towards accomplishment of the mission and vision of the company,
- Supports the work of the Board of Directors through proposals related to policies and decisions that Board will make,
- Responsible for services provided by the company, monitoring the quality of program for preparing services, marketing and sale of these services,
- Proposes the annual budget to be approved by the Board of Directors and with competency manages financial sources of the company within applicable laws and regulations,
